

CAMERA PENALE DI

Il carcere possibile

o.n.l.u.s.



Udhëzues për të
drejtat dhe detyra
e të burgosurve

© IL CARCERE POSSIBILE ONLUS

registered office

Napoli, Centro Direzionale, Palazzo di Giustizia, Camera Penale di Napoli

central office

Napoli, Via S. Lucia N. 123

www.ilcarcerepossibileonlus.it - info@ilcarcerepossibileonlus.it

në bashkëpunim me

Departamentin e Administrimit të Burgut

Seksionin e Rajonit të Kampanjës

dhe Drejtoritë e Institutit të Ariano Irpino, Arienzo, Avellino, Benevento,

Carinola, Eboli, Lauro, Napoli-Poggioreale, Napoli-Secondigliano,

Pozzuoli, S.M.C.Vetere, Sala Consilina, Salerno, Vallo della Lucania,

dhe Spitalet Psikiatrike të Paraburgimit të qyteteve Aversa e Napoli

patronazhin dhe kontributin e

Rajonit së Kampanjës

Aksekrorati I Veprimtarive Produktive

Garantit Të Personave Që U Janë Nënshtruar

Masave Kufizuese Të Lirisë Personale Të Regione Campania

Këshillit Të Rendit Të Avokatëve Të Napolit

Përkthimi në shqip, arabisht, frëngjisht, anglisht dhe rumanisht nën kujdesin e Qendrës "Lifelong Learning" të Universitetit "l'Orientale"



Consiglio dell'Ordine
degli Avvocati di Napoli



Università della Sicilia Meridionale
"l'Orientale"
Centro di Ricerca e Formazione

Falënderojmë, për punën e bërë, Avokatët:

Marialessandra Cangiano, Francesco Cossu, Brunella Fraietta, Elena Lepre, Angelo Mastrocola, Riccardo Polidoro, Massimo Vetrano.

Prof. Adriana Tocco "Garante e personave që u janë nënshtruar masave kufizuese të lirisë personale të Regione Campania"

Prof. Luigia Melillo, Presidente e Qendrës Lifelong Learning të Universitetit të Napolit "L'Orientale"

Shkrimtaren Valeria Parrella

Zotin Stefano Vecchio - Drejtor i Departamentit Varësi të të Varurve nga Droga ASL NA1

Zotin Rino Pastore - Përgjegjës NJVT Shër.T Fusha Penale e Departamentit të të Varurve nga Droga për paragrafin 4 të kapitullit IX

Prof. Raffaele Pempinello - Drejtor V UOC, Departamenti i Sëmundjeve Infektive me Komplexitete të Larta dhe të lidhura me SIDA-n - A. O. "D. Cotugno"

Zonjën Maria Donata Iannece - Drejtuese UOS e Suportit Infektivologjik tw Burgut A.O. "D. Cotugno" për paragrafin 5 të kapitullit IX

*I wish to gaze again on such a land,
Free earth: where a free race, in freedom, stand.
Then, to the Moment I'd dare say:
'Stay a while! You are so lovely!'
Through aeons, then, never to fade away
This path of mine through all that's earthly.*

Goethe, Faust

Një udhëzues quhet kështu, sepse është një gjë që udhëzon, domethënë që të hap rrugën. Këtu është rruga e vështirë e burgimit italian, por megjithatë një rrugë është diçka që duhet përshkuar e, edhe në këtë mund të gjendet një kuptim. Shpresa e atyre që janë "jashtë" është ajo që të burgosurit dhe familjet e tyre të mos ndihen të izoluar, që të dinë se rruga drejt një burgimi dinjitoz e përshkujmë bashkë, dhe udhëzuesi është njëri prej mjeteve të menduar për një gjë të tillë, që të na japë NEVE mundësinë për të shoqëruar "për krahu" atë që ka nevojë për ndihmë, informacion, sqarime. Sepse nuk ekziston një mundësi tjetër për atë individ që dëshiron të jetojë me dinjitet, përveç se garantimi apo luftimi me qëllim që ky dinjitet të bashkëndahet.

Valeria Parrella

BURGU I MUNDUR OJF

“Burgu i Mundur” lind, në prill të vitit 2003, si “projekt” i Dhomës Penale të Napolit, e cila më pas është kthyer në OJF.

“Burgu i Mundur OJF” kërkon t’ia arrijë qëllimit të solidaritetit shoqëror, civil dhe kulturor ndaj personave të burgosur, duke pasur parasysh parimet e sanksionuara nga neni 27, paragrafi i dytë dhe i tretë i Kushtetutës së Republikës Italiane “I pandehuri nuk konsiderohet i fajshëm deri në momentin e dhënies së dënimit definitiv”; “Nuk mund të jepen dënime çnjerezore dhe ato duhet të synojnë riedukimin e të dënuarit”.

Mes qëllimeve të Shoqatës është edhe tutelimi në çdo seli, edhe në atë të paraburgimit, i të drejtave të të burgosurve dhe për të nxitur veprime, edhe ligjore, në mbrojtje të këtyre të drejtave, për të pretenduar respektimin e tyre dhe për të kërkuar pagimin e dëmeve që mund t’u shkaktohen të burgosurve.

Gjatë këtyre viteve ka zhvilluar një veprimtari konkrete denoncimi të kushteve të jetesës brenda InSTITUTEVE të Burgut dhe ka nxitur nisma të shumta për riedukimin dhe rifutjen e të burgosurve në jetën civile.

Bashkëpunon vazhdimisht me Sektorin e Administrimit të Burgut dhe me “Garantin e personeve që u janë nënshtruar masave kufizuese të lirisë personale” të Regione Campania.

HYRJE pag. 117

KAPITULLI I pag. 119

HYRJA NË INSTITUT. VEPRIMTARITË E PARA

Nga Zyra e Matrikullimit të qelia
 Komunikimi i burgimit familjarëve
 Emërimi i mbrojtësit
 Paratë
 Situata personale. Pozicioni juridik

KAPITULLI II pag. 127

INSTITUTI. ORGANIZIMI I TIJ

Qelia
 Kompletet
 Njohja e figurave referuese
 “Transportimi i të burgosurve”
 Kontrollet

KAPITULLI III pag. 132

RREGULLAT E SJELLJES

Rregullat që duhen respektuar
 Ndëshkimet e parashikuara
 Gjendja e ruajtjes së veçantë
 Masa parandalimi
 Pezullimi dhe Falja e ndëshkimeve
 Procedura disiplinore
 Shpërblimet

KAPITULLI IV pag. 138**KËRKESAT**

“Kërkesa me shkrim”

“Modeli 13”

E drejta e ankimimit

Kërkesat bërë Gjykatës së Mbikëqyrjes

Kërkesë për punë të brendshme dhe shpërblimi

Puna e bërë jashtë

Kërkesa e shpërnguljes

Kërkesë për të votuar në zgjedhje

KAPITULLI V pag. 147**MARRËDHËNIET JASHTË INSTITUTIT**

Takimet

Telefonatat

Pakot

Posta

KAPITULLI VI pag. 152**USHQIMI**

Ushqyerja

Tregtimi

Përfaqësimi i të dënuarve

KAPITULLI VII pag. 154**BESIMI FETAR - SHKOLLIMI - VEPRIMTARIA SPORTIVE**

Liria fetare

Arsimimi

Aktivitetet sportive

KAPITULLI VIII pag. 157**TË DËNUARIT E HUAJ**

Masa e dëbimit

Leja e qëndrimit për arsye të drejtësisë

E drejta e përkthimit dhe të përkthyesit

Konventa e Strasburgut

KAPITULLI IX pag. 162**SHËNDETI**

Higjiëna

Mënyra e të jetuarit

Ndihma shëndetësore

Varësia nga droga

SIDA

KAPITULLI X pag. 168**SHPENZIMET E GJYQIT DHE MBAJTJA NË BURG**

Shpenzimet

Falja e borxhit

Për të burgosurit punëtorë

KAPITULLI XI LIRIMI NGA BURGU

Liria

pag. 169

KAPITULLI XII NGA ANA E FAMILJES

Ndjenja e humbjes

Avokati

Pozita juridike

Bisedat, pakot, posta, telefonatat

pag. 170

SHTOJCË

Garanti i personave që u janë nënshtruar masave

kufizuese të lirisë personale

Aspektet të ndryshme organizative

Pyetësor i Instituteve të Rajonit Kampania

pag. 172

HYRJE

“Udhëzuesi” dëshiron t’u japë atyre që janë të burgosur dhe familjarëve të tyre një mjet për t’u orientuar në burg, me qëllim që të bëjnë një burgim të vetëdijshëm për të drejtat që atyre u njihen dhe për rregullat që duhen respektuar.

Normat në këtë fushë, jo gjithmonë lexohen saktë dhe u mungon një koordinim që mund të ketë një vizion organik dhe të plotë. Jemi përpjekur të përvijojmë një rrugëtim dhe të shoqërojmë personin e burgosur në ecjen e mundimshme të mungesës së lirisë.

Nisma të ngjashme janë ndërmarrë edhe prej të tjerëve. Le të kujtojmë “udhëzuesit” e botuar në Padova, Torino, Gjenova, Verona, Firenze e Bolonjë, të cilat mund t’i konsultoni në www.ristretti.it, sit i gazetës së Shtëpisë së Burgimit të Padovës dhe të Institutit të Dënimit Femëror të Gjudekës.

Puna jonë, edhe pse i ka pasur parasysh këto përvoja, dëshiron të karakterizohet për “konstestualizimin” e informacioneve të ofruara, që i referohet në veçanti praktikave që janë në fuqi në Institutin e Rajonit të Kampanjës.

Shumë i rëndësishëm bashkëpunimi i Departamentit të Administrimit të Burgut dhe në veçanti i Sektorit të Rajonit të Kampanjës dhe i Drejtorisë së Instituteve, si edhe i Garantit të të Drejtave të të Burgosurve të Rajonit të Kampanjës.

Informimi i të burgosurve dhe i familjeve të tyre është një detyrim juridik, por edhe një detyrë morale solidariteti. Është një detyrë e sanksionuar nga ligji që pasqyron parimet më elementare të qytetërimit, duke qenë se humbja e lirisë së të burgosurve dhe pritja e të afërmeve duhet, në një

moment vështirësie të veçantë ekzistenciale, të shoqërohen nga qartësia dhe nga transparencja.

HYRJA NË INSTITUT. VEPRIMTARITË E PARA

1. Nga Zyra e Matrikullimit te qelia

Kontakti i parë zyrtar me strukturën e burgut bëhet në Zyrën e Matrikullimit ku i burgosuri kontrollohet, i merren shenjat e gishtërinye dhe të dhënat personale, si edhe i bëhen fotografitë përkatëse.

I jepet numri i amzës, i cili nuk do të ndryshohet gjatë gjithë kohës së burgimit.

Të hollat, të gjitha objektet me vlerë dhe gjithçka që gjykohet se duhet kontrolluar, i merren të burgosurit.

Më pas, mund të kërkohet kthimi i disa objekteve, nëse kanë vlerë të ulët dhe nëse lejohen nga Drejtoria, duke i drejtuar një kërkesë me shkrim Drejtorisë.

Biseda e parë, që bëhet me një ekspert të Shërbimeve të Vëzhgimit dhe të Trajtimit, paraqet momentin në të cilin është e nevojshme të komunikohen problematika që kanë lidhje me situata personale të veçanta.

Kjo bisedë, së bashku me informacione që kanë lidhje me akuzën, me përkatësinë e mundshme në një organizatë kriminale, me të qenit përdorues droge apo me gjëra që janë të rendit seksual, do të ndihmojë në përcaktimin e repartit dhe të trajtimit që personi do t'i nënshtrohet.

Hapet një dosje personale, në të cilën do të vendosen të gjitha të dhënat që kanë lidhje me personin dhe vetë "historia" e të burgosurit. Në fund të çdo semestri shënohet gjykimi i shprehur nga drejtoria, themelor për njohjen e përfitimeve.

Brenda ditës së dytë të hyrjes në burg personi do t'i nënshtrohet vizitës mjekësore.

Në këtë rast personi duhet t'i tregojë mjekut çdo problem të mundshëm që ka lidhje me shëndetin: varësi nga alkooli apo droga, alergji, ushqime të dëmshme, nevojë për dieta specifike apo ilaçe. Është e nevojshme që personi t'i dorëzojë të gjitha dokumentet mjekësore që ka, për të bërë të mundur që struktura shëndetësore e Institutit të ketë referime të nevojshme për dallimin dhe trajtimin e patologjive të mundshme.

Pas përfundimit të veprimeve të hyrjes, një agjent i policisë së burgut kujdeset për transferimin në qeli dhe i jep të burgosurit të nënshkruajë një fletë në të cilën është përshkruar gjendjen e saj.

Është e rasti, përpara se të nënshkruajë, të kontrollojë që të gjitha objektet të jenë realisht në gjendjen e përshkruar, meqë dëmet që këto objekte do të pësojnë pas këtij momenti e në vazhdim do të paguhen prej të burgosurit.

2. Komunikimi i burgimit familjarëve

Njihet e drejta për të lajmëruar familjarët për burgimin, nëpërmjet një letre apo telegrami. Nëse personi nuk ka të holla, ato duhet të sigurohen nga Administrata, duke siguruar pullat e postës dhe letrën apo duke dërguar telegramin, me anë të një kërkesë që i burgosuri bën me shkrim dhe të motivuar. Kjo bëhet nëpërmjet një kërkesë me shkrim, duke specifikuar mungesën e të hollave.

Administrata merr përsipër vetëm të transmetojë lajmin për hyrjen e parë dhe/apo të një transferimi të mundshëm të mëvonshëm.

Për të huajin është e mundur t'i kërkohet Zyrës së Matrikullimit, që Ambasada apo Konsullata të lajmërohen për burgimin.

3. Emërimi i mbrojtësit

Gjykatësi, në mungesë të një mbrojtësi të besuar, emëron një mbrojtës zyre, emri i të cilit bëhet i njohur gjatë masës paraprake, që është dhënë në momentin e arrestimit. Ky emërim, si i mbrojtësit të besuar apo i atij të zyrës, është gjithmonë i nevojshëm, meqë mbrojtja në proces ushtrohet detyrimisht nëpërmjet mbrojtësit. Është e mundur që të emërohen deri në dy mbrojtës të besuar. Emërimi i një mbrojtësi të tretë, pa shkarkuar të paktën njërit nga të mëparshmit, nuk ka asnjë vlerë.

Emërimi i mbrojtësit të besuar bashkëmbart përjashtimin kontestual dhe të menjëhershme të mbrojtësit të zyrës.

Nëse është emëruar mbrojtësi i besuar përpara Autoritetit Gjyqësor, është e këshillueshme që ky emërim të formalizohet, sa më shpejt, pranë Institutit të Burgut nëpërmjet modelit përkatës të vënë në dispozicion nga Administrata. Kjo vlen për të garantuar bisedën, brenda një kohe të shkurtër, me Avokatin vetjak. Në fakt, jo gjithmonë struktura administrative kompetente është e informuar, për emërimin e bërë në aktet e procedimit penal, për bisedat me mbrojtësin dhe jo gjithmonë Avokati që shkon në burg për të kërkuar një bisedë me të burgosurin që asiston zotëron një akt gjyqësor, që të vërtetojë cilësinë e tij si mbrojtës i emëruar.

Nëse i burgosuri nuk di kë të zgjedhë për mbrojtës të besuar, por gjithsesi dëshiron ta zgjedhë vetë mbrojtësin e vet dhe të mos përfaqësohet nga ai i zyrës, mund të konsultohet Urdhri i Avokatëve të Rrethit, pranë Zyrës së Matrikullimit.

Është absolutisht e ndaluar që personeli i Administratës së Burgut, si dhe vetë Agjentët e Policisë Gjyqësore, që bëjnë arrestimin, të japin emrin e mbrojtësit.

Personi ka të drejtë të bisedojë menjëherë me mbrojtësin e vet,

përveç rasteve kur autoritetet gjyqësore, në momentin e arrestimit, nuk kanë vënë një ndalim të motivuar, që nuk mund të jetë më shumë se 5 ditë.

Si mbrojtësi i besuar, ashtu edhe ai i zyrës, duhet të paguhen, për punën e bërë.

Kur personi ndodhet në një situatë të vështirë ekonomike merret në patronazh nga Shteti (c.d. Patronazh Falas). Në këtë rast, pagesa e mbrojtësit, shpenzimet e procesit, honoraret e mundshme të konsulentëve dhe të hetuesve, nuk do të rëndojnë mbi të burgosurin. Të gjithë mund ta gëzojnë këtë të drejtë, italianë, të huaj dhe ata që janë pa shtetësi, por që banojnë në Vend.

Për t'u marrë në patronazh nga Shteti, është e nevojshme që personi të ketë të ardhura të tatueshme, që rezulton nga deklarimi i fundit i të ardhurave, jo më shumë se 10.628,16 Euro, limite që rishikohen çdo dy vjet.

Shifra është shtuar me 1.032,91 Euro për çdo familjar bashkëjetues. Shifra e mësipërme përcaktohet nga shuma e të ardhurave të të gjithë përbërësve të bërthamës familjare.

Përrjashtohen nga patronazhi falas të hetuarit, të pandehurit dhe ata që janë dënuar, me vendim definitiv, për krime fiskale.

Gjithashtu, ndërhyrje të fundit legjislative kanë futur një ndalim të mëtejshëm për subjektet e dënuar me vendim të formës së prerë për krime të organizuara mafioze, apo që kanë pasur për qëllim të favorizojnë organizata mafioze dhe episode të rënda të shpërndarjes së drogës.

Ai që merret në patronazh falas mund të asistohet nga një mbrojtës i vetëm.

Nevojitet ta nënshkuajë vetë kërkesën me aktin e marrë nga Drejtori i Institutit, që do ta shënojë në Regjistrin përkatës dhe do t'ua paraqesë

apo do t'ua dërgojë Autoriteteve Gjyqësore. Gjithashtu kërkesa mund t'ua paraqitet drejtpërdrejtë Autoriteteve Gjyqësore, nëpërmjet mbrojtësit të emëruar, që do të vërtetojë nënshkrimin. Efektet e kërkesës fillojnë, në çdo rast, nga data e paraqitjes së saj.

Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një vetë-çertifikatë e kërkuarit dhe përbërja e bërthamës familjare, siç del nga gjendja familjare, ku shënohen të ardhurat, nëse zotërohen pasuri të patundshme apo të tundshme të regjistruara, fallsiteti i të cilave përbën krim.

Kërkuari jo italian duhet t'i bashkëngjisë, vetë-çertifikatës mbi të ardhurat që merr jashtë, një çertifikatë të Autoriteteve Konsullore, ku pohohen deklaratat e tij në lidhje me të mirat apo të ardhura që merr në vendin e origjinës. Në rast të pamundësisë për ta përgatitur menjëherë kjo çertifikatë mund të dorëzohet në një moment të dytë, por jo më shumë se pas 20 ditëve, nga mbrojtësi i emëruar apo nga një familjar.

Vetëm mbrojtësve të regjistruar në Urdhrin specifik të c.d.-së "patronazh falas" do t'ua njihet pagesa e honorarit nga ana e Shtetit. Urdhri është vënë në dispozicion nga Instituti i Burgut.

4. Paratë

Paratë nuk lejohen të qarkullojnë në burg dhe ndalohet mbajtja e tyre. Ashtu siç kemi parë, kur personi hyn në burg, paratë tërhiqen dhe ruhen me kujdes në zyrën administrative llogaritare të burgut. Të burgosurit i lihet një fletë me shumën e parave që ka, që quhet "librezë", e cila herë pas here përditësohet me llogaritë e shpenzimeve të bëra në burg dhe hyrjet e mundshme.

Paratë mund t'i dërgohen të burgosurit prej jashtë nga kushdo, por vetëm me mandapostë; është e ndaluar marrja e parave nëpërmjet letërkëmbimit.

Mënyra më e thjeshtë dhe më pak e kushtueshme, për ta derdhur, nga ana e familjarëve dhe e bashkëjetuesve dhe e personave që pranojnë në biseda, është ajo e dorëzimit në sportelet përkëtesë të burgut.

Shpenzimet për blerjen e produkteve në dorë apo jashtë burgut për c.d. sopravitto, apo për telefonatat dhe letërkëmbimin postal shënohen të gjitha në "librezë" dhe janë të mundura vetëm nëse personi zotëron shumën e nevojshme.

Shuma maksimale e parave për çdo person është deri më 1.000,00 € për të dënuarit dhe deri në 2.000,00 € për ata që janë në pritje të gjyqimit. Nëse kjo shumë kalohet (p.sh. për një urdhërxhirim të bërë nga punëdhënësi, për të cilin punon jashtë), paratë duhet të depozitohen në një librezë depozite pranë një banke jashtë burgut.

I burgosuri, gjithashtu, mund të kujdeset për pagimin e honorarit të mbrojtësit me kërkesë paraprake dhe shuma hiqet nga librezja. Në këtë rast, kufiri i shumës së depozituar mund të tejkalohet, ashtu si edhe për shpenzimet që kanë lidhje me gjoba e pagesa borgjesh.

5. Situata personale. Pozicioni juridik

Pozicioni juridik personal është themelor, sepse prej këtij pozicioni varet mundësia për të kërkuar apo jo autorizime dhe/apo përfitime.

Pozicioni juridik sipas fazave të procesit

NË MASË PARANDALUESE

në fazë hetimi: i hetuar

pas kërkesës apo dërgimit gjyqësor: i pandehur

të gjykuar të shkallës së parë: apelues

të gjykuar të shkallës së dytë: ankues

GJATË SHLYERJES SË DËNIMIT

Kur vendimi është i formës së paapelueshme/i formës së prerë: definitiv

Autoriteti referues, për autorizimet, është:

ai gjyqësor deri në vendimin e shkallës së parë;

drejtori i burgut apo zyrtari mbikëqyrës në të gjitha rastet e tjera, në të cilat personi ka statusin e apeluesit (deri në vendimin e shkallës së dytë), të ankuesit (nëse personi është në pritje të vendimit të Gjykatës së Lartë), definitivit (nëse vendimi i dënimit është bërë i pakthyeshem, i formës së prerë).

Autoriteti referues për përfitimet e parashikuara nga Rregulloret Gjyqësore, që u lejojnë vetëm "definitivëve", është Gjykata apo Gjykata e Mbikëqyrjes së vendit të burgimit.

Dënimi i dhënë me vendim të formës së prerë për krimet e parashikuara në nenin 4 bis, të Rregullores Gjyqësore, pengon të pasurit e përfitimeve, të të drejtave dhe të autorizimeve, për këto krime:

kundravajtjet penale të bëra me qëllim terrorizmin apo prishjen e rendit demokratik;

kundravajtjet penale të organizatave kriminale të llojit mafioz;

kundravajtjet penale të rënduara nga ndihmimi i këtyre organizatave apo të bëra për t'i ndihmuar ato;

kundravajtjet penale që kanë lidhje me sklavërimin, tregtinë e personave, blerjen dhe shitjen e skllërvëve;

kundravajtjet penale të sekuestrimit të personit me qëllim zhvatjen e tij;

kundravajtjet penale të organizatave kriminale që kanë për qëllim kontrabandën e duhanit të punuar jashtë;

kundravajtjet penale të organizatave kriminale që kanë për qëllim trafikimin e paligjshëm të substancave narkotike.

Në këto raste pengimi mund të hiqet atëherë kur subjektet e dënuar bashkëpunojnë me drejtësinë apo kur vërtetohet, nga Gjykatëse përkatëse e Mbikëqyrjes pamundësia apo pakthyeshmëria apo padobishmëria apo parëndësia e bashkëpunimit, gjithmonë nëse më parë është vërtetuar se personi nuk ka më lidhje me krimin e organizuar.

Kufizimet e përfitimeve parashikohen për subjektin e dënuar për këto kundravajtje penale:

vrasje me dashje

prostituim i të miturve e kundravajtje penale më të rënda në fushën pornografike

kundravajtje penale përdhunimi seksual

vjedhje dhe zhvatje në rrethana rënduese

kundravajtje penale kontrabande në rrethana rënduese neni 291 ter DPR nr. 43/73

mbajtje në sasi të mëdha të substancave narkotike

organizata që kanë për qëllim kryerjen e krimeve të përdhunimit seksual dhe të shkeljes së udhëzimit në lëndën e imigrimit

organizata që kanë për qëllim kryerjen e krimeve të falsifikimit dhe të tretimit të prodhimeve me të dhëna të rreme.

INSTITUTI. ORGANIZIMI I TIJ

1. Qelia

Instituti janë organizata që të mund të krijojnë ndarje në Seksione, sipas kriterëve që i përgjigjen arsyeve të sigurisë dhe për të shmangur kontaktet mes subjekteve me rrezikshmëri kriminale të ndryshme.

Qelia, e përcaktuar nga ligji “dhomë”, duhet të respektojë disa parametra për të qenë sipas rregullave.

Dritaret duhet të lejojnë kalimin e drejtpërdrejtë të dritës dhe të ajrit natyror. Nuk lejohen mbrojtje që pengojnë këtë kalim. Mbrojtjet mund të vendosen vetëm për arsye sigurie, por sidoqoftë duhet të lejojnë një kalim të mjaftueshëm të dritës dhe të ajrit.

Çelësat e ndriçimit artificial të dhomave, si edhe të funksionimit të aparateve të radios dhe TV-së, lidhen si jashtë, për personelin, ashtu edhe brenda. Personeli mund të ndalojë funksionimin e tyre të brendshëm, kur përdorimi rrezikon bashkëjetesën e rregullt.

Ndriçimi gjatë natës, që mundëson kontrollin nga ana e personelit, duhet të jetë me intensitet të ulët.

Shërbimet higjienike, të kompletuara me lavaman dhe dush, lidhen me një kthinë aneks me dhomën dhe duhet të jenë të pajisur me ujë të rrjedhshëm të ngrohtë dhe të ftohtë.

2. Kompletet

Administrata e Burgjeve jep gjërat e nevojshme për higjienën personale, shtratin, rrobat dhe veshjet e brendshme.

Për secilën veshje është parashikuar kohëzgjatja e përdorimit. Nëse prishja para kohe nuk shkaktohet nga përdorimi, duhet të shpaguehet

dëmi.

Personi mund të lejohet të përdorë gjërat e veta personale. Sigurohet një shërbim lavanderie të cilin secili mund ta përdorë me shpenzimet e veta.

3. Njohja e figurave referuese

Pas hyrjes në Institut është e rëndësishme që personat të mësojnë menjëherë se cilat janë figurat e referimit dhe mbi të gjitha cilat janë kompetencat e tyre.

Instituti, sipas madhësisë, do të ketë më shumë apo më pak personel, por zakonisht struktura për mbarështimin e tij është si vijon.

DREJTORIA, e përbërë nga Drejtori dhe Nëndrejtorët. Struktura është përgjegjëse për mënyrën e mbarështimit dhe për drejtimin e veçantë të politikës së burgimit të Institutit. Drejtorisë personi mund t'i drejtohet - siç do të shihet më poshtë - me letër apo me ashtuquajtura “kërkesë me shkrim”.

FORCAT E POLICISË SË BURGJEVE, figura qendrore dhe themelore për organizimin e Institutit. Asaj i atribuohen jo vetëm detyra mbrojtjeje dhe sigurie, por edhe pjesëmarrjeje në trajtimin edukues, në fushën e grupit të punës. Asaj i caktohet shërbimi i transferimit dhe atij të rojës në vendet jashtë (p.sh. spitalet).

Në Institut në marrëdhëniet me personelin përdoret “ju”. Personeli i drejtohet të dënuarit me mbiemër, ndërsa i dënuari i drejtohet personelit me rolin që ka. Policia e Burgut dallohet dhe thirret sipas gradave:

AGJENT (spaleta pa grada, apo me një shigjetë të vetme të kuqe);

Asistent (spaleta me dy, apo tre, shigjeta të kuqe);

Epror (spaleta me një, apo më shumë, breza argjendi);

Inspektor (spaleta me një, apo më shumë, pesëkëndësh argjendi);

Komisar apo Komandant (spaleta me dy apo tre yje argjendi).

FUSHA EDUKUESE, që organizon dhe koordinon veprimtaritë e jashtme, shkollën, punën, nismat kulturore dhe sportive, në bashkëpunim me operatorët e tjerë. Edukatorët marrin pjesë në grupin e vëzhgimit dhe trajtimit, që përcakton procesin riedukues të subjektit.

SHËRBIMI I TOKSIKOMANËVE (SHËR.T.), që ndihmon ato që paraqesin problematika toksikomanie dhe varësie nga alkooli. Jep ndihmesë sanitare dhe rehabilitimi, me biseda orientimi dhe programe terapeutike.

Punonjësit social që përkujdesjen për marrëdhëniet me jashtë, në veçanti me familjet dhe veprimtaritë e punës. Kanë kontakte me burimet jashtë dhe shërbimet territoriale, për integrimin kur të përfundojë dënimi.

ZYRA E EKZKUTIMIT PENAL TË JASHTËM (Z.E.P.J.), me detyrë ndjekjen jashtë të të dënuarit që i është dhënë një masë alternative kundrejt dënimit, si nëse vjen nga instituti (i dënuar), ashtu edhe nëse pranohet drejtpërdrejt nga gjendja “e lirë”.

Zhvillon hetime shoqërore dhe familjare dhe i propozon Autoritetit Gjyqësor programin e edukimit për t'u zbatuar për të dënuarit që kërkojnë të pranohen në masat alternative kundrejt dënimit. Kontrollon zbatimin e programit dhe i përgjigjet Autoritetit Gjyqësor, duke i propozuar ndryshimet e mundshme apo edhe heqjen nga programi.

PSIKOLOGU që, me kërkesën e Drejtorisë, kujdeset për vëzhgime dhe trajtime, “Psikologu i burgut” një është figurë e përhershme, e vazhdueshme dhe thelbësore, sepse bashkërendon punën e drejtorisë, të edukatorit, të punonjësit social dhe të mjekut. Ka fituar, me kalimin e kohës, kompetenca të reja: “Zyra e të sapoardhurve” dhe e të varurve nga droga.

PUNONJËS VULLNETARË që nuk janë vartës të Administratës së Burgjeve dhe merren me përkujdesjen edukuese. Janë të autorizuar të frekuentojnë Institutet e burgjeve për të bërë aktivitete që synojnë mbështetjen morale dhe ri-integrimin e ardhshëm në jetën shoqërore,

tënë ndryshe të bashkëpunojnë me qendrat e shërbimeve sociale për besimin në provë, për gjendjen gjysmë të lirë dhe për ndihmën ndaj të liruave dhe familjeve të tyre.

Të dënuarit mund të kenë bashkëbisedime me vullnetarët, duke i bërë një kërkesë Drejtorisë.

Takimi, pa praninë e të tretëve, ka të bëjë mbi të gjitha në dëgjimin e nevojave të personave për të kuptuar se cilat janë ndërhyrjet e nevojshme. Mes të cilave:

Mbështetja morale. Vullnetari mund të ndihmojë për të kapërcyer çastet e krizës dhe gjendjet e ankthit, që vijnë nga jetesa në burg apo nga fakti se kanë ndërprerë në mënyrë të menjëhershme marrëdhëniet me familjarët.

Ndihmë praktike. Vullnetari mund ta ndihmojë të dënuarin që të plotësojë disa nevoja. Si të marrë libra, cigare apo veshje.

Informacione. Vullnetari mund të japë informacione dhe të bashkëpunojë në:

Dokumentet e gjendjes civile dhe të gjendjen familjare (bashkëpunimi me zyrat e komunave e të punës për lëshimin e librezës së punës dhe të kodit fiskal, për regjistrimin në listat e punëkërkuarëve, për prokurat dhe marrjen e pensionit)

Dokumente sigurimi dhe shoqërore

Dokumente për shkollën, universitetin, të dhëna për të bërë provimet

Të dhëna për funksionimin e sistemit juridik

Të dhëna për shërbimet territoriale terapeutike të caktuara për alkoolin, varësinë nga droga dhe patologji të tjera

Pjesëmarrja në ritet fetare.

4. “Transportimi i të burgosurve”

Organizimi i Institutit parashikon edhe shoqërimin nga vendi i burgimit jashtë tij, p.sh. nga Instituti në Gjakovë për të marrë pjesë në gjyq. Një shoqërim i tillë përcaktohet si “transportim i të burgosurit”.

Në transportimet individuale përdorimi i prangave është i detyrueshëm kur personi është i rrezikshëm apo ka rrezik që të ikë dhe/apo sepse rrethanat mjedisore e bëjnë problematike shoqërimin. Një vlerësim i tillë bëhet nga Autoriteti Gjyqësor përkatës apo nga Drejtoria e Institutit.

Në transportimet kolektive është i detyrueshëm përdorimi i prangave modulare të shumëfishta.

Ligji përcakton që Policia e Burgjeve duhet të ketë kujdesin e nevojshëm për t'i larguar personat e dënuar nga kureshtja dhe çdo formë e dhunimit të “privatësisë”.

5. Kontrollat

Rastet kur është i mundur kontrolli janë të përcaktuara nga Rregullorja e Brendshme e secilit Institut dhe vetëm për arsye sigurie. Në situata të papërcaktuara nga Rregullorja është i nevojshëm urdhri i Drejtorit.

Në rastet e urgjencave të veçanta, personeli vepron me nismën e vet, duke lajmëruar menjëherë Drejtorin, duke specifikuar arsyet që kanë përcaktuar urgjencën.

Kontrollat bëhen nga dy persona që i përkasin Forcave të Policisë së Burgjeve (në raste të jashtëzakonshme, si kontrole të përgjithshme, edhe nga Forcat e Policisë) të së njëjtës gjini me subjektin që duhet kontrolluar. Gjatë kontrollit duhet të tregohet respekt si ndaj dinjitetit të personit, ashtu edhe ndaj gjërave që i përkasin atij.

Kur personi transferohet në një Institut tjetër, para transferimit ai i nënshtrohet gjithmonë kontrollit personal.

RRÉGULLAT E SJELLJES

1. Rregullat që duhen respektuar

Në burg ka rregulla të sakta që është e nevojshme të njihen e të respektohen. Dhunimi i këtyre rregullave sjell si pasojë ndëshkime që rëndojnë gjendjen tashmë të vështirë të të dënuarit.

Jeta e burgut rregullohet nga Rregullorja e Burgjeve, nga Rregullorja e Zbatimit të Urdhrit të Burgjeve dhe nga Rregullorja e Brendshme e Institutit, nëse instituti ka një të tillë.

Këtyre burimeve normative mund t'u shtohen sjellje të konsoliduara, që, edhe pse jo të shkruara, caktojnë ndalime dhe përshkruajnë sjellje.

Sjelljet për të cilat parashikohet një ndëshkim janë:

1. neglizhencë në pastrimin dhe rregullimin e personit apo të dhomës;
2. braktisje e pajustificuar e vendit të caktuar;
3. moszbatim i vullnetshëm i detyrimeve të punës;
4. sjellje dhe qëndrime të dhunshme ndaj të burgosurve të tjerë;
5. lojëra apo veprimtari të tjera jo të lejuara nga rregullorja e brendshme;
6. shtirje sëmundjeje;
7. trafikim të mirash të cilat janë të lejuara në pronësi;
8. mbajtje apo trafikim i sendeve jo të lejuara apo të parave;
9. komunikime të jashtëligjshme me jashtë apo brenda gjatë kohës së izolimit për zbatimin e ndëshkimit të përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta;
10. vepra të turpshme apo kundra moralit publik;
11. kërcënim i shokëve apo mbizotërim në lidhje me to;

12. falsifikim i dokumenteve me prejardhje nga Administrata dhe që i janë besuar mirëmbajtjes së të dënuarit;
13. përvetësim apo dëmtim i të mirave të Administratës;
14. mbajtje apo trafikim i mjeteve që dëmtojnë;
15. sjellje ofenduese ndaj punonjësve të burgut apo të personave të tjerë që hyjnë në Institut për punë apo vizita;
16. moszbatim i urdhrave apo ndalesave apo vonesë e pajustificuar në zbatimin e tyre;
17. vonesa të pajustificuara në kthim në rast lejeje, gjysmë lirie, autorizimeve;
18. pjesëmarrje në çrregullime apo kryengritje;
19. promovim i çrregullimeve dhe i kryengritjeve;
20. ikje;
21. faktet të parashikuara nga ligji si krime, të bëra në dëm të shokëve, të punonjësve të burgut apo vizituesve.

2. Ndëshkimet e parashikuara

Nuk mund të ndëshkohesh për një sjellje që nuk është e parashikuar qartë si shkelje. Ndëshkimi mund të jepet vetëm si masë e motivuar. Pas shpalljes të ndëshkimit, pranohemi të shfaqim shfajësimet tona.

Organet e caktuara për dhënien e ndëshkimit janë Drejtori i Institutit dhe për rastet më të rënda Këshilli i Disiplinës i përbërë nga Drejtori (në mungesë të tij nga personi me gradën më të lartë) me rolin e Presidentit, nga një sanitar dhe nga një edukator.

Ndëshkimet e parashikuara janë:

Qortimi i Drejtorit. Është ndëshkimi më i lehtë.

Qortimi i dhënë nga Drejtori që bëhet në praninë e personelit dhe të një grupi të burgosurish.

Përjashtim nga veprimtaritë argëtuese dhe sportive për një kohë

maksimale prej 10 ditësh (dhënë nga Këshilli i Disiplinës).

Izolimi gjatë qëndrimit në ajër të pastër për jo më tepër se 10 ditë (dhënë nga Këshilli i Disiplinës).

Përgjashtimi nga veprimtaritë e përbashkëta deri në një maksimum prej 10 ditësh (dhënë nga Këshilli i Disiplinës); Është ndëshkimi më i rëndë. Ka të bëjë me izolimin e vazhdueshëm që zbatohet në një dhomë të zakonshme, përveç rastit kur sjellja e personit është e tillë sa bezdis apo dëmton rendin e disiplinën. Të izoluarit nuk mund të komunikojnë me shokët. Ky ndëshkim nuk mund të zbatohet pa vërtetimin me shkrim dhënë nga mjeku, që vërteton që subjekti mund ta përballojë. Ai që përjashtohet nga veprimtaritë e përbashkëta i nënshtrohet një kontrolli të vazhdueshëm mjekësor.

Nuk është i lejuar përdorimi i forcës fizike dhe nuk mund të përdoret asnjë mjet detyrues, veçse për të penguar apo parandaluar akte dhune. Agjentët në shërbim nuk mund të mbajnë armë brenda Institutit.

Është e mundur të bëhet ankimim Gjyqtarit të Vëzhgimit për të kundërshtuar ndëshkimin e dhënë.

Është e rëndësishme të kihet parasysh se zbatimi i një ndëshkimi mund të pengojë dhënien e "lirimit para afatit" një përfitim që ka të bëjë me një zbritje të dënimit prej 45 ditësh, për çdo gjashtëmuor burg.

3. Gjendja e ruajtjes së veçantë

Ato që pengojnë sigurinë d.m.th. që turbullojnë rendin e Instituteve, apo me dhunë e kërcënime pengojnë veprimtarinë e të dënuarve apo të internuarve të tjerë, apo përfitojnë nga nënshtrimi i të dënuarve të tjerë ndaj tyre, mund t'i nënshtrohen gjendje së ruajtjes së veçantë për një kohë jo më të gjatë se 6 muaj, që mund të përsëritet disa herë, por në masë, secilën herë, jo më të madhe se tre muaj.

Masa, pas miratimit të Këshillit të Disiplinës, jepet nga Administrata

e Burgut. Për të pandehurit merret mendimi edhe i Autoritetit Gjyqësor përkatës.

Në rast nevojë dhe urgjence Administrata mund të japë, përkohësisht, ruajtjen e veçantë para miratimeve të parashikuara, por sido të jetë ato duhet të merren brenda 10 ditëve.

Kundër masës mund të bëhet ankesë në Gjykatën e Ruajtjes. Ankesa nuk ndalon zbatimin.

Gjendja e ruajtjes së veçantë përfshin ndalesa të lidhura ngushtë me mbajtjen e rendit dhe të sigurisë. Kufizimet tregohen në masën që jepet.

Mund të ketë kufizime e kontrole mbi letërkëmbimin. Sidoqoftë kufizimet nuk mund të kenë të bëjnë me: higjienën dhe kërkesat e shëndetit, ushqimin, blerjen apo marrjen e ushqimeve dhe të sendeve të lejuara nga rregullorja e brendshme në kufirin në të cilin kjo nuk përbën rrezikshmëri për sigurinë; leximin e librave dhe të gazetave të përditshme; veprimtarinë fetare; përdorimin e radios; kohëqëndrimin në mjedise të hapura për të paktën dy orë në ditë, veçse në raste të jashtëzakonshme, takimet me mbrojtësit, me bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët, prindërit, vëllezërit.

4. Masa parandalimi

Në rastin e një urgjence absolute, si p.sh. parandalimi i trazirave, Drejtori mund të japë, si masë parandaluese, me masë të motivuar, që ai që ka bërë një thyerje të disiplinës të ndëshkueshme me masën e ndalimit nga veprimtaria e përbashkët, të qëndrojë në një dhomë individuale në pritje të thirrjes së Këshillit të Disiplinës.

Masa e sigurisë si do të jetë nuk mund të kalojë 10 ditë dhe mund të jepet vetëm pas vizitës mjekësore, që vërteton se subjekti mund ta përballojë. Koha e kaluar në masën e sigurisë zbritet nga kohëzgjatja e

ndëshkimit që mund të jepet.

5. Pezullimi dhe Falja e ndëshkimeve

Zbatimi i ndëshkimit mund të ndërpritet me kusht, për 6 muaj, kur hamendësohet se përgjegjësi nuk mund të bëjë më shkelje të tjera. Nëse brenda këtij afati subjekti bën shkelje të tjera disipline pezullimi hiqet dhe ndëshkimi zbatohet; përndryshe shkelja shuhet.

Për rrethana të jashtëzakonshme Autoriteti që ka dhënë ndëshkimin mund ta anulojë atë.

6. Procedura disiplinore

Raporti i shkruar nga një punonjës i burgut që ka vërejtur një shkelje apo mëson për të, i jepet Drejtorit nëpërmjet një eprori.

Drejtori në praninë e Komandantit të Policisë së Burgut, i jep gjykimin të akuzuarit, jo më shumë se 10 ditë nga raportimi, duke e informuar për të drejtën për të paraqitur shfaqësimet e veta.

Drejtori, personalisht apo nëpërmjet personelit, sigurohet. Brenda 10 ditëve nga data e akuzës, nëse mendon se duhet të jepet një qortim apo vërejtje, thërret të akuzuarin për t'i dhënë vendimin disiplinor. Për ndëshkime të tjera, cakton, në të njëjtat afate, ditën dhe orën e hirrjes së të akuzuarit para Këshillit të Disiplinës. Ndëshkimi jepet dhe i bëhet me dije gjatë këtij takimi, në të cilin i akuzuari ka mundësi të paraqesë shfaqësimet e veta.

7. Shpërblimet

Atyre që janë shquar për angazhim në zhvillimin e punës, në kurse shkollore apo formimi profesional, në veprimtaritë kulturore, argëtuese e sportive, që kanë treguar ndjeshmëri të veçantë dhe gatishmëri në dhënien e ndihmës së të dënuarve të tjerë, u jepen - me nismën e

Drejtorit - shpërblime si vijon:

lavdërim (dhënë nga Drejtori);

propozim për dhënieje përfitimesh alternative kundrejt burgimit (dhënë nga Këshilli i Disiplinës, pas dëgjimit të Grupit të Vëzhgimit);

propozim për falje, për lirim me kusht dhe heqje para kohe të masës së sigurisë (dhënë nga Këshilli i Disiplinës, pas dëgjimit të Grupit të Vëzhgimit).

KËRKESAT

1. “Kërkesa me shkrim”

Çdo veprimtari duhet të autorizohet paraprakisht. Për këtë arsye duhet të paraprihet me një kërkesë specifike, e paraqitur me shkrim, duke plotësuar formularin e posaçëm të vënë në dispozicion nga Instituti dhe të përcaktuar si “kërkesëza” që duhet t’i drejtohen Drejtorisë duke e vendosur në kutinë e pranishme në çdo seksion.

“Kërkesëza” e përdorur për çfarëdo veprimtarie të përditshme brenda Institutit, por që nuk mund të përdoret jashtë tij, parashikohet, mes të tjerash:

- për të bërë një telegram apo një letër rekomande;
- për të tërhequr një pako postare;
- për të marrë, me anë të takimeve, ato ushqimet që kanë nevojë për autorizim
- për të blerë produkte jo të përfshira në listën e pazarit;
- për të marrë libra nga biblioteka;
- për të ndërruar qeli apo seksion;
- për të frekuentuar veprimtari sportive, argëtuese, kulturore dhe të llojeve të tjera;
- për të bërë takime duke i parë apo në telefon me familjarët apo bashkëjetuesit;
- për të kërkuar një ndihmë në mungesë të burimeve ekonomike;
- për të kërkuar takim me Drejtorin, Komandantin, Përgjegjësën e Zyrës së Komandës apo atë të Zyrës së Matrikullimit;
- për të kërkuar një takim me Drejtorin pedagogjik, me punonjësit social të C.S.S.A., me operatorët SERT apo me psikologun;

për të kërkuar një takim me meshtarin, asistentin vullnetar të autorizuar;

për të kërkuar kopje të dokumenteve apo të masave.

2. “Modeli 13”

Kërkesat që nuk mund të bëhen me anë të “kërkesëzës” i paraqiten Zyrës së Matrikullimit, duke plotësuar të ashtuquajturin “Model 13”. Për të shkuar tek Zyra e Matrikullimit është e nevojshme të bëhet një prenotim, që bëhet duke i dhënë mbiemrin agentit të seksionit.

Kërkesat e mundshme për Drejtorin dhe Komandantin mund t’u dërgohen atyre në një letër në zarf të mbyllur, që nuk ka nevojë për pullë postare.

3. E drejta e ankimit

Është e mundur t’i bëhet kërkesë apo ankimim me zë apo me shkrim, edhe në zarf të mbyllur:

- Drejtorit të Institutit
- Inspektorëve
- Drejtorit të Departamentit të Administrimit të Burgjeve
- Ministrin të Drejtësisë
- Gjyqtarit të burgut Gjykatës së Mbikëqyrjes
- Mbikëqyrësit për të drejtat e të dënuarve
- Autoritetit Gjyqësor e Sanitar në vizitë në Institut
- Presidentit të Këshillit të Qarkut
- Presidentit të Republikës

4. Kërkesat bërë Gjykatës së Mbikëqyrjes

Për të përfutur masat alternative kundrejt burgimit është e mundur t’i bëhet kërkesë Gjykatës së Mbikëqyrjes, së cilës i atribuohet mbikëqyrja

e organizimit të Instituteve duke u kujdesur në mënyrë të veçantë për zbatimin e trajtimit riedukues. Gjykata e Mbikëqyrjes siguron ndër të tjera që zbatimi i burgimit të bëhet sipas ligjeve dhe rregulloreve.

Përpilimi i kërkesës është i thjeshtë, sepse mjafton të shënohet lloji i përfitimit që kërkohet. Masat alternative kundrejt burgimit janë:

Lirimi i parakohshëm (neni 54 i Rregullores së Burgut) - Gjykata e Mbikëqyrjes së Burgjeve mund ta zvogëlojë dënimin me 45 ditë për çdo gjashtëmujor dënim të bërë nëse i dënuari ka dhënë prova pjesëmarrjeje në punën e riedukimit. Zakonisht, meqenëse programet riedukuese mungojnë apo janë për pak vetë, përfitimi i jepet atij që ka pasur një sjellje të mirë gjatë burgimit. Llogaritet edhe koha e vuajtjes në paraburgim si në Institut, ashtu edhe në arrest shtëpie, gjithashtu vuajtjen e masave alternative. Nëse kërkesa për lirim të parakohshëm hidhet poshtë, mund të bëhet ankimim i motivuar, brenda dhjetë ditëve nga marrja e urdhëresës. Mungesa e arsyeve bëhet shkak për mospranimin e ankimit. Është mirë të saktësohet gjithmonë koha e dënimit në lidhje me të cilin kërkohet përfitimi, gjithashtu edhe koha e paraburgimit, duke treguar vendet e vuajtjes.

Besimi në provë në shërbimin social (neni 47 i Rregullores së Burgut) - Gjykata e Mbikëqyrjes, pasi vlerëson personalitetin në bazë të vëzhgimeve të sjelljes në Institut, mund të japë besimin në provë në shërbimet sociale, nëse dënimi që mbetet për të vuajtur është më i ulët se 3 vjet. Përfitimi jepet që të mund të lehtësohet ri-integrimi shoqëror. Kjo periudhë mund të numërohet për të përfutur lirinë e parakohshëm. Është mirë që kërkesës t'i bashkëngjitet dokumentacioni që provon mundësitë konkrete të ri-integrimit shoqëror, mes të cilave privilegjohet veprimtaria e punës.

Liria e pjeshme (neni 50 e 50 bis i Rregullores së Burgut). Gjykata e Mbikëqyrjes mund ta japë lirinë e pjeshme që ka të bëjë me kalimin

e ditës jashtë Institutit, për t'u kthyer në mbrëmje. Përfitimi jepet për të mundësuar zhvillimin e një veprimtarie pune, arsimimi apo gjithësi të dobishme për ri-integrimin shoqëror. Mund të jepet për të dënuarin me burg jo më tepër se 6 muaj apo me arrestim. Nëse dënimi i dhënë është më i madh, duhet që të jetë bërë gjysma e tij. Nëse vuajtja është njëra prej atyre që parashikohet në nenin 4 bis të Rregullores së Burgut (shih kapitulli I paragrafi 5), kërkohet vuajtja e dy të tretave të dënimit. Në rast faji të përsëritur, duhet të jenë vuajtur dy të tretat e dënimit, pra tre të katërtat e tij nëse ka patur dënim për një nga shkeljet për të cilin flet nenin 4 bis i Rregullores së Burgut. Nëse personi është dënuar me burgim të përjetshëm ai duhet të ketë bërë 20 vjet burg.

Burgim shtëpie (neni 47 ter i Rregullores së Burgut). Gjykata e Mbikëqyrjes mund të lejojë dënimin në shtëpi, që ka të bëjë me vuajtjen në shtëpisë apo në një vend kurimi, asistence apo pritjeje. Burgimi në shtëpi mund të jepet: në rastin kur dënimi që mbetet ende për t'u bërë nuk është më i madh se 4 vjet, kur ka të bëjë me: gra shtatzënë apo me nëna fëmijët e të cilave janë në moshë më të vogël se 10 vjeç, që bashkëjetojnë me të; baballarë që kanë në kujdestari fëmijë me moshë më të vogël se 10 vjeç, që bashkëjetojnë me të, nëse nëna ka vdekur apo në pamundësi për t'i dhënë ndihmën fëmijëve; persona me gjendje shëndetësore veçanërisht të rënduar, që kërkojnë kontakte të vazhdueshme me qendrat shëndetësore territoriale; persona të paaftë, edhe pjesërisht, që kanë kaluar moshën 60 vjeç; persona me moshë më të vogël se 21 vjeç për arsye shëndetësore, arsimi, pune dhe familjeje. Në të gjitha këto raste kufiri i vuajtjes për t'u kryer zvogëlohet nga 4 në 3 vjet, nëse kemi të bëjmë me të dënuar me gabime të përsëritura. Mund të jepet sidoqoftë burgimi në shtëpi, nëse dënimi për t'u kryer është më i vogël se 2 vjet, pavarësisht nga të gjitha gjendjet e përmendura më sipër, nëse nuk ka arsye për të përfutur besimin në provë në shërbimin

shoqëror; në këto raste nuk duhen të hiqet një dënim i dhënë për njërin nga krimet e përcaktuara në 4 bis të Rregullores së Burgut (shih kapitulli I paragrafi 5) dhe nuk duhet të jetë dënuar për gabime të përsëritura. Burgimi në shtëpi mund t'u jepet edhe atyre që kanë mbushur 70 vjeç, që nuk janë shpallur kriminelë përsëritës, profesionalë apo për prirje dhe që nuk janë dënuar për të njëjtin krim. Përjashtohen në çdo rast, nga një masë e tillë alternative, të dënuarit për krimet që parashikohen në nenin 4 bis të Rregullores së Burgut (shih kapitulli I paragrafi 5) dhe për veprat si vijon: për prostitucion të miturish, pornografi të miturish, mbajtje materiali pornografik të prodhuar me anë të shfrytëzimit seksual të të miturve, nismave turistike që kanë për qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të miturve, dhunë seksuale, vepra seksuale me të mitur, dhunë seksuale në grup, bërja pjesë në një grup me qëllim bërjen e krimeve të kthimit dha mbajtjes në skllavëri, trafik personash, blerja dhënie skllavërisht.

Masa alternative për subjektin e sëmurë me SIDA të shpallur apo me mungesë të rëndë imuniteti (neni 47 quater i Rregullores së Burgut). Cilado qoftë vuajtja që mbetet për të shlyer, i dënuari që vuan nga SIDA e shpallur apo nga mungesa e theksuar e imunitetit, mund të pranohet në besimin në provë në shërbimin social apo në burgim shtëpie për të filluar një program të veçantë kurimi. Në këtë rast kërkesës duhet t'i bashkëngjitet vërtetimi mjekësor i përpiluar nga shërbimi shëndetësor publik përkatës apo nga ai i burgjeve që vërteton patologjinë dhe mundësinë e fillimit të një programi pranë një strukture spitalore, që punon sipas planeve rajonale në ndihmë të rasteve të sëmurëve me SIDA.

Lejet. Gjykatësi i burgjeve, pasi dëgjon mendimin jo të detyrueshëm të Drejtorit të burgut, mund të jap leje-shpërblim për një kohëzgjatje maksimale prej 15 ditësh dhe sidoqoftë jo më shumë se 45 ditë për

çdo vit burgu të bërë. Edhe në këtë rast parashikohen disa kushte: 1) i dënuari me burg jo më shumë se 3 vjet; 2) i burgosuri me një dënim më të madh se 3 vjet, por që ka vuajtur tashmë të paktën $\frac{1}{4}$ e dënimit; 3) për faje të përsëritura parashikohet kushti që të ketë vuajtur të paktën $\frac{1}{3}$ e dënimit. Nëse ka pasur dënim për një nga krimet e parashikuara në nenin 4 bis të Rregullores së Burgut (shih kapitulli I paragrafi 5), është e nevojshme që i burgosuri të ketë vuajtur gjysmën e dënimit apo të paktën 10 vite. Kufi i ngritur në $\frac{2}{3}$ e dënimit apo të paktën 15 vite për fajtorët përsëritës. Për të dënuarit e përjetshëm kërkohet vuajtja e të paktën prej 10 vjetësh.

Lejet për arsye të rënda familjare. Në rastin e rrezikut të pritshëm për jetën e një familjari apo bashkëjetuesi, Gjyqtari i Burgut mund t'i japë të dënuarve dhe të internuarve lejen për të shkuar për të vizituar të sëmurin, me kujdesin e parashikuar në rregulloren dhe parashikimin e shoqëruesve. Për të akuzuarit, gjatë gjyqit të shkallës së parë, leja mund të jepet nga gjykatësi pranë të cilit zhvillohet gjyqi, pas vendimit të shkallës së parë të Presidentit të Gjykatës së Apelit. Lejet mund të jepen në mënyrë të jashtëzakonshme për raste familjare të një rëndësie të veçantë. I dënuari që nuk kthehet në Institut me mbarimin e lejes pa një arsye të justifikuar ndëshkohet në rrugë disiplinore nëse mungesa zgjat më shumë se 3 orë dhe jo më shumë se 12 orë. Në raste të tjera ndëshkohet për krimin e ikjes nga burgu.

Autorizime. Mund t'u jepen ekskluzivisht subjekteve gjysmë të lirë (të nënshtruar gjendjes gjysmë të lirisë) apo të internuarve (të nënshtruar masave të sigurisë me burg: shtëpi pune, qendër bujqësore, shtëpi kure apo besimi, spital psikiatrik i burgjeve). Gjysmë të lirët mund të kërkojnë autorizime për një periudhë e cila sidoqoftë nuk i kalon 45 ditë në vit. Nëse gjatë kësaj kohe shkelen detyrimet, gjysmë liria mund të hiqet. Të internuarit mund të kërkojnë autorizime me kohëzgjatje jo më të gjatë

se 15 ditë për nevoja personale apo familjare; jo më shumë se 30 ditë, një herë në vit, me qëllim lehtësimin e ri-integrimit shoqëror; 6 muaj në kohën që paraprin mbarimin e masës.

Kundër masës së Zyrës së Burgjeve është mundur të paraqiten ankime.

Ankimimet duhet të shoqërohen gjithmonë nga arsyet të vlefshme. Mund të shkruhen edhe arsye shtesë nga mbrojtësit, por këshillohet shkrimi që ka të bëjë me veprën kjo për të shmangur mospanime të ardhshme dhe të mundshme si shkak mosfunksionimeve të llojeve të ndryshme. Nga statistikat, pjesa më e madhe e ankimeve të paraqitura deklarohen të papranueshme për mungesë arsyesh.

5. Kërkesë për punë të brendshme dhe shpërblimi

Puna në burg nuk ka karakter ndëshkues dhe shpërblehet.

Pagesa përcaktohet me lidhje me sasinë dhe cilësinë e punës së bërë, në masë jo më të vogël se 2/3 e trajtimit ekonomik të parashikuar në kontratat kolektive të punës.

Një komision i posaçëm cakton trajtimin ekonomik të punëtorëve dhe nxënësve. Komisioni cakton edhe numrim maksimal të orëve të mungesës nga puna të paguara.

Janë të detyrueshme, për personat në ngarkim, shpërblimet familjare në masën sipas ligjit. Shumat e shpërblimit familjar u jepen drejtpërdrejtë personave në ngarkim apo u dërgohen atyre.

Për mundësinë e ndalimit të të hollave të shpërblimit, shih kapitullin përkatës për shpërblimet personale dhe të mbajtjeve të të hollave në burg.

Me kërkesë drejtuar Drejtorisë mund të kërkohet pranimi në veprimtarinë e punës, duke saktësuar llojin e veprimtarisë (punë e përgjithshme, shtëpiake, ndërtimi, kuzhine etj.)

Meqënëse nuk ka mundësi për t'i punësuar të gjithë ata që bëjnë kërkesë, përdoren kriteret vlerësimi që marrin parasysh ngarkesën familjare, titullin e studimit, kualifikimin profesional, nevojën, vjetërsinë e papunësisë duke filluar nga burgimi.

Pra, këto kushte duhet të tregohen në kërkesën dhe mund të jenë objekt vetëdeklarimi.

Për subjektet e dënuara në mënyrë definitive, shpërblimi për punën e bërë në burg do të mbahet në fond të gatshëm (3/5) dhe të përcaktuar (2/5).

Paratë e fondit të përcaktuar do të jepen në fund të dënimit pas pagesës së shpenzimeve të drejtësisë dhe mbajtjes në burg, por në rast se ka nevojë të arsyetuar, që nuk mund të mbulohet pagesa duke përdorur fondin në dispozicion, është e mundur të kërkohet heqja e shumës nga fondi i përcaktuar, me anë të kërkesës që i bëhet Drejtorit.

6. Puna e bërë jashtë

Është një mënyrë e zbatimit të dënimit që mundëson daljen nga Instituti për të zhvilluar veprimtari pune apo për të bërë kurse formimi profesional.

Puna e bërë jashtë bëhet pa shoqërim, pos rasteve në të cilat ai mendohet i nevojshëm për arsye sigurie.

Mund të parashikohet për:

të përhershmit për krime të zakonshme pa asnjë kufizim që ka të bëjë me gjendjen juridike e me kohën e kaluar në burg;

të dënuar me burgim me njërin prej krimeve të përcaktuara në nenin 4 bis të Rregullores së Burgut (shih kapitulli I paragrafi 5) pas kryerjes të paktën të 1/3 të dënimit e sidoqoftë të paktën 5 vjet;

të dënuarit me burgim të përzetshëm pas vuajtjes së të paktën 10 viteve.

Është një masë me natyrë administrative që jepet nga Drejtori dhe që miratohet, me kufizimet e rastit, nga Gjykata e Mbikëqyrjes.

7. Kërkesa e shpërnguljes

Kërkesa e shpërnguljes për arsye shëndetësore, studimi apo për arsye familjare, nuk është nën kompetencën e autoritetit gjyqësor. Nëse kërkohet shpërngulja në një Institut që ndodhet një të njëjtin rreth, kërkesa duhet t'i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Administratës së Burgjeve. I burgosuri duhet t'i drejtohet Drejtorisë së Administratës së Burgjeve nëse nuk është nën varësinë e Drejtorisë Rajonale.

Shpërnguljet caktohen nga zyra për arsye të rënda dhe të provuara të sigurisë, për nevojat e institutit, për arsye drejtësie.

Kur është e mundur duhet të lehtësohet kriteri i dërgimit të të interesuarve në Institute pranë shtëpisë së tyre.

8. Kërkesë për të votuar në zgjedhje

Të gjithë ata që kanë të drejtë vote mund ta ushtrojnë atë edhe gjatë periudhës së dënimit.

Është parashikuar ngritja, brenda strukturës së burgut, e një qendre votimi të veçantë.

Por i dënuari, nëse dëshiron të votojë, duhet t'i dërgojë në kohë Kryetarit të Komunës ku është i regjistruar, një deklaratë me anë të së cilës i bën me dije dëshirën e vet për të shprehur votën brenda mjedisit të rezidencës. Një deklaratë e tillë duhet të përmbajë vërtetimin nga ana e Drejtorit të strukturës, që tregon gjendjen e burgimit dhe duhet t'i mbërrijë Kryetarit maksimumi tre ditë përpara fillimit të votimeve.

MARRËDHËNIET JASHTË INSTITUTIT

1. Takimet

Çdo i dënuar ka të drejtë të bëjë takime me bashkëshortë e bashkëjetues dhe me Garantin e të drejtave të të dënuarve, në mjedise të caktuara nën kontrollin pamor, por jo dëgjimor të personelit të rojes.

Takimet me mbrojtësit në gjendje të zakonshme burgimi, nuk kanë nevojë për autorizime dhe kufizime nga ana e administratës së burgut.

Takimet me familjarët (bashkëshortë dhe bashkëjetues) shihen pozitivisht nga ligji, sepse perceptohen si mjete të nevojshme për riedukimin dhe trajtimin e të dënuarit. Për këtë arsye Drejtoria e Institutit ka për detyrë t'i lejojë dhe t'i mbështesë këto vizita, duke i bërë me dije shërbimit social të administrimit për rastet në të cilin figuron se familjarët nuk kanë marrëdhënie me të dënuarin.

Me bashkëshortët dhe bashkëjetuesit sigurohen gjashtë takime në muaj, nga të cilët të paktën një çdo javë.

Në rastet e parashikuara nga 4 bis të Rregullores së Burgut (shih kapitulli I paragrafi 5) takimet mujore janë katër.

Me familjarë kuptohen prindërit, fëmijët, bashkëshorti, vëllezërit dhe motrat, vjehrritë, kunetërit, xhaxhallarët dhe nipërit. Me bashkëjetues kuptojmë ato që janë të regjistruar në të njëjtën certifikatë familjare.

Në rastin kur takimet zhvillohen me fëmijë me moshë më të vogël se 10 vjeç është e mundur të bëhet një numër më i madh takimesh.

Mund të lejohet një numër më i madh takimesh nëse personi është në gjendje të rëndë shëndetësore; në këtë rast takimi mund të bëhet edhe në mjediset e infermierisë.

Janë të mundura edhe takime me persona të tjerë kur ka nevoja të

veçanta dhe arsye të motivuara, si p.sh. zbatim i akteve juridike (noteri, këshilltarë, mjekë, etj.), por takime të tilla duhen të jenë të gjitha gjithnjë të autorizuara.

Në takim mund të marrin pjesë tre persona përnjëherësh; nëse kemi të bëjmë me takime me bashkëshortë apo bashkëjetues numri i pjesëmarrësve mund të jetë më i madh.

Kohëzgjatja e takimeve është një orë. Nëse nevojat e organizimit të Institutit e lejojnë, mund të zgjatet deri në dy orë për familjarët që banojnë larg nga vendndodhja e burgut dhe, nëse në javët paraardhëse, nuk ka pasur takim.

Personat e pranuar në takime identifikohen dhe kontrollohen.

Gjatë takimit duhet mbajtur një sjellje korrekte, përndryshe është mundësia e ndëshkimit me pezullimin e takimit.

Zakonisht takimet e parashikuara nga rregullorja me bashkëshortët apo bashkëjetuesit autorizohen përgjithësisht në hyrjen në Institut dhe në takimin e parë në të cilin janë marrë dokumentet që vërtetojnë marrëdhënien familjare apo gjendjen familjare.

Kështu në të gjitha rastet e tjera të takimit me familjarët apo persona të tjerë kanë nevojë për autorizimin dhe kërkesën përkatëse e cila duhet t'i dërgohet:

Autoriteteve Gjyqësore që gjykon deri në dhënien e vendimit të shkallës së parë;

Drejtorit të Institutit pas dhënies së vendimit.

Për ato që janë të dënuar për krime të listuara në nenin 4 bis të Rregullores së Burgut (shih kapitulli I paragrafi 5) autorizimi jepet gjithmonë nga Autoriteti Gjyqësor paraardhës.

2. Telefonatat

Një herë në javë i burgosuri mund të autorizohet për t'i telefonuar familjarëve apo bashkëjetuesve, apo edhe personave të tjerë (si p.sh. avokatit mbrojtës), për arsye të vlefshme.

Të dënuarit për krime të parashikuara në nenin 4 bis të Rregullores së Burgut (shih kapitulli I paragrafi 5) kanë të drejtë vetëm për dy telefonata në muaj. Në të tilla raste telefonatat regjistrohen gjithmonë.

Është i parashikuar një përjashtim, në numrin e telefonatave, për arsye urgjence të një rëndësie të veçantë apo nëse këto bëhen me fëmijët të moshës më të vogël se 10 vjeç.

Kërkesa për të marrë autorizimin duhet t'i bëhet Drejtorisë së Institutit, që nga ana e saj do t'ia përcjellë:

deri në vendimin e shkallës së parë gjykatësit që e gjykon;
pas vendimit të shkallës së parë Drejtorit të Institutit.

Kur merret autorizimi, është e nevojshme të paraqitet një kërkesëz për të bërë telefonatën, duke treguar përdoruesin, personin që i burgosuri dëshiron të kontaktojë, ditën dhe orën.

Duhet të tregohet edhe cila gjuhë do të përdoret nëse kemi të bëjmë me një gjuhë të ndryshme nga italishtja.

Telefonatat mund të bëhen vetëm në rrjetin fikse, asnjëherë në celular. Telefonata mund të zgjasë maksimumi 10 minuta.

Shpenzimi nuk është në ngarkim të Administratës së Burgjeve dhe mund të bëhet edhe me anë të skedës telefonike të parapaguar.

Autorizimi mund të tërhiqet në çdo çast, por gjithmonë me një vendim të motivuar.

Nëse prejardhja është nga një burg tjetër, në të cilin ka pasur autorizim për të telefonuar, është e nevojshme të kërkohet autorizimi i ri.

3. Pakot

Mund të marren 4 pako në muaj me peshë të përgjithshme jo më të madhe se 20 kg..

Pakot mund të dërgohen me postë (por në këtë rast mund të jepen vetëm nëse në 15 ditën më përpara nuk ka pasur asnjë takim) apo të dorëzuara nga personat e pranuar në takim.

Pakot i nënshtrohen kontrollit dhe mund të jenë edhe ushqime. Sendet që kontrollohen me vështirësi mund të mos jepen për arsye sigurie e kontrolli.

Mund të pranohen libra (jo me mbulesë të fortë), revista apo materiale të tjera didaktike edhe më tepër se pesha e parashikuar.

4. Posta

Është e mundur të dërgohet dhe të merret posta (letra, telegram edhe fax), pa kufizime. Në letër duhet shkruar emri e mbiemri.

Gjërat e nevojshme, përveçse të shiten në dyqan, mund t'i jepen nga ana e administratës të dënuarit që nuk ka fonde.

Njihet e drejta e privatësisë, pra letrat nuk mund të lexohen. Por instituti para se ta dërgojë letrën apo të japë atë që vjen nga jashtë, bën një kontroll për të parë nëse ka sende apo gjëra të palejueshme.

Gjykatësi mund të nënshtrojë censurë ndaj letërkëmbimit, kështu që në letër do të vendoset viza.

Nëse drejtorja ka dyshime që në letërkëmbim ka përmbajtje që lidhet me një krim apo që kanë lidhje me një rrezik për rendin e sigurinë, e mban letrën dhe lajmëron Autoritetin Gjyqësor kompetent. Në këtë rast, i burgosuri informohet se letërkëmbimi i tij është mbajtur.

Por mund të jepen kufizime të lirisë së letërkëmbimit për arsye e veprimtari hetimi, gjithashtu edhe për arsye sigurie e rendi në Institut. Masa nuk mund të jepet për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj,

që mund të shtyhet për periudha jo më të gjata se tre muaj.

Kur letërkëmbimi u dërgohet pjesëtarëve të Parlamentit, përfaqësive diplomatike apo konsullore të shtetit që i përket, organizmave në mbrojtje të të drejtave njerëzore, mbrojtësve, nuk mund të ketë kufizime.

USHQIMI

1. Ushqyerja

Duhet të këshillohet një ushqyerje e shëndoshë dhe e mjaftueshme, që përcaktohet në bazë të moshës, gjinisë, gjendjes shëndetësore, punës, stinëve dhe klimës, ashtu siç e parashikon tabela e miratuar me dekret të ministrisë. Nëse ka probleme të veçanta, p.sh. tretjeje apo përtypjeje, i tregohet mjekut (do të ishte e rastit të bëhej në çastin e kontrollin që në hyrje), i cili mund të këshillojë dhe të japë një dietë të përshtatshme.

Ushqimi nuk mund të kufizohet për arsye disiplinore, për shkak të një sjelljeje të mbajtur në burg. Të burgosurit i takojnë tre vakte në ditë dhe duhet të jetë gjithmonë i mundshëm përdorimi i ujit të pijshëm.

Kuzhina mund të kujdeset për ushqimin e jo më shumë se 200 personave.

2. Tregtimi

Mund të blihen, te dyqani i mbarështuar nga Administrata e Burgjeve apo nga sipërmarrje që ushtrojnë shitjen me çmime të kontrolluara, produkte ushqimore dhe të llojeve të tjera, të shënuara në një listë të veçantë. Çmimet nuk mund të jenë më të larta se ato të vendit ku ndodhet burgu.

Mund të shpenzohen maksimumi 424,00 € në muaj të barabarta me 106,00 € në javë. Në shuma të tilla janë të përfshira të gjitha shpenzimet (ushqime, kancelari, telefonata, dërgesa etj..).

Ushqimet mund të gatohen në qeli me furnela me gaz, si ato të kampingut, edhe ato në shitje në dyqan.

Rekomandohet t'i kushtohet një vëmendje maksimale zierjes së ushqimeve, për arsye higjieniko-sanitare.

Nëse personi është i besimit mysliman, lind e drejta për të pasur një ushqim ndryshe, që respekton kulturën e përkatësisë. Në këtë rast, i bëhet një kërkesë e veçantë drejtorisë.

Ndër të tjera mund të merren edhe ushqime, përveç pijeve alkoolike, edhe nga jashtë, nëpërmjet pakove të sjella nga personat e pranuar në takim apo të nisura me postë.

3. Përfaqësimi i të dënuarve

Një përfaqësi e personave të dënuar e zgjedhur muaj për muaj me short dhe së bashku me një person të caktuar nga Drejtori, çdo mëngjes kontrollon sasinë dhe cilësinë e ushqimeve të nevojshme për përgatitjen e ushqimit, vërteton që ushqimet janë konsumuar krejtësisht e që çmimet e dyqanit janë në përputhje me rregullën.

Nëse i burgosuri bën pjesë në përfaqësi, ai ka të drejtë të kërkojë leje nga puna apo shkolla për kryerjen e kësaj detyre.

Në institute në të cilat përgatitje e ushqimin bëhet në më shumë se një kuzhinë, krijohet një përfaqësi për secilën kuzhinë.

Çdo parregullsi duhet t'i bëhet me dije drejtorit.

BESIMI FETAR - SHKOLLIMI - VEPRIMTARIA SPORTIVE

1. Liria fetare

Liria fetare është konsideruar si një e drejtë personale dhe si e tillë duhet të sigurohet në mishërimin e saj praktik: liria për të shpallur besimin personal, për t'u edukuar në të dhe për të ushtruar kultin. Kjo e drejtë duhet të njihet në mënyrë të përshtatshme edhe në burg.

Në çdo burg është i siguruar festimi i riteve të besimit katolik dhe për këtë qëllim, çdo instituti i është caktuar të paktën një meshtar.

Është e garantuar, në përputhje me organizimin e përgjithshëm të jetës në Institutit, pjesëmarrja në shërbimet fetare apo takimet e adhurimit. Mund të mbahen libra dhe botime që kanë të bëjnë me besimin dhe që paraqesin imazhe dhe simbolet fetare në dhomë.

Nëse ka persona që i përkasin një besimi tjetër nga ai katolik, ka të drejtë të marrë me kërkesë, ndihmën e ministrave të besimit që i përket dhe të kremtojë ritet. Nëse numri i personave e justifikon dhe rrethanat e lejojnë, prania mund të jetë e përhershme. Instituti duhet të autorizojë përfaqësuesin e kualifikuar të emëruar apo të miratuar, që të organizojë periodikisht shërbimet e veprimtaritë fetare dhe të kryejë vizita të veçanta baritore, gjatë kohës të rezervuara për këtë gjë.

Takimi me një përfaqësues të kualifikuar të një besimi fetar nuk mund të refuzohet nga Administrata. Po ashtu respektohet sjellja negative apo mospërfillëse ndaj çdo besimi fetar.

2. Arsimimi

Arsimi është një e drejtë themelore për zhvillimin dhe rritjen e personalitetit dhe formimin kulturor e atë profesional.

Pra, duhet të sigurohet së bashku me zhvillimin e veprimtarive krijuese, intelektuale apo manuale, brenda institucionit të burgut, në mënyrë që të burgosurit të ndjekin një proces formimi që i jep gjerësi e mundësi e shpresë për një jetë më të mirë, që zakonisht jep arsimimi.

Pra, Instituti i burgut duhet të sigurojë organizimin e kurseve për arsimin e detyruar dhe kurset e trajnimit profesional.

Organizimi dhe mbarëshkrimi i kurseve arsimore janë përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit. Titujt e studimit të dhëna kanë të njëjtën vlerë si ato të marra jashtë.

Ndër të tjera është lehtësuar pjesëmarrja në kurse shkollore me korrespondencë, nëpërmjet radios dhe/apo televizionit.

Një kujdes i veçantë duhet t'u kushtohet atyre që janë nën moshën 25 vjeç, me qëllim që të bëjnë një formim profesional të përshtatshëm me kushtet normale të punës për një ri-integrim më të lehtë në shoqëri.

Përdorimi i botimeve që ndodhen në bibliotekën e Institutit është një e drejtë e njohur, me lirinë e plotë të zgjedhjes së leximeve. Në qelë mund të mbahen: gazeta, revista dhe libra që shiten jashtë, me të vetmin kufizim, të natyrës thjeshtë sasiore, kjo për arsye të rregullit dhe të hapësirës. Mund të përdoren ndër të tjera mjete të tjera informimi: radio apo TV (mjete të siguruar drejtpërdrejtë nga Administrata e burgjeve), pra një aparat radio personal që vetë-ushqehet.

Nëse gëzon gjysmë lirinë i burgosuri ka të drejtë të ndjekë shkollën dhe veprimtaritë arsimore të organizuara jashtë institucionit; përkushtimi i vazhdueshëm në mësim do të lejojë që të përfitohen të mira ekonomike të parashikuara për nxënësit, ashtu siç mund të jetë një parakusht për të marrë ndonjë ulje të mundshme të dënimit.

3. Aktivitet sportive

Organizimi i një veprimtarie të tillë është nën përkujdesjen e një

komisioni që përbëhet nga Drejtori, nga një apo më shumë edukator, një ose më shumë punonjës socialë dhe nga një përfaqësues prej pesë të dënuarish me parashikim e pesë zëvendësuese për këta të fundit. Të dënuarit që janë pjesë e komisionit zgjidhen me anë të një shorti që hidhet çdo katër muaj.

Nëse i burgosuri dëshiron të marrë pjesë në ndonjë kurs duhet të bëjë një kërkesë me shkrim.

TË DËNUARIT E HUAJ

1. Masa e dëbimit

Të dënuarit e huaj duhet të verifikojnë pranë Zyrës së Matrikullimit të Burgut nëse, pos dënimit me burg, së bashku me vendimin e dënimit mos i është dhënë edhe masa e dëbimit. Kjo masë do të zbatohet vetëm pas shlyerjes së dënimit. Në çdo rast duhet të rishikohet ekzistenca e supozimin të aktualitetit të rrezikshmërisë shoqërore me caktimin nga ana e Gjykatës të Mbikëqyrjes së një seance të veçantë rishqyrtimi.

I dënuari ka të drejtë të marrë pjesë në këtë seancë, edhe duke kërkuar një leje të përkohshme qëndrimi për arsye drejtësie.

Dëbimi mund të jepet edhe në rrethana të tjera:

Si një dënim alternativ i atij me burgim jo më të shumë se dy vjet (në rastet në të cilat nuk gjen zbatim lirimi me kusht i dënimit), është vendosur nga gjykatësi në vendim (edhe në rastet e ujdisë). Në këtë rast dëbimi nuk mund të ketë një kohëzgjatje më të vogël se 5 vjet.

Si dënim administrativ, vendosur nga Kuestori, për shkeljen e ligjit të imigracionit;

Jepet gjithmonë në rastet e dënimit për vepra kundër personaliteteve shtetërore (terrorizëm, bandë e armatosur, konspiracion politik, etj.)

Dëbimi mund të jepet menjëherë, apo me kërkesë nga ana e Gjykatës së Mbikëqyrjes kur masa e burgimit, edhe e mbetur, nuk i tejkalon dy vjetët dhe kur i burgosuri nuk po shlyen një dënim të dhënë për krime ostativi që lidhen me lehtësime burgimi (neni 4 bis i Rregullores së Burgut). Në qoftë se masa është e menjëhershme, i dënuari mund ta kundërshtojë me arsyetim para Gjykatës së Burgut brenda dhjetë ditëve nga data e urdhrorit të dëbimit.

Në çdo rast, dëbimi nuk mund të kryhet kur i huaji, në vendin e origjinës së tij, rrezikon të përndiqet për arsye racore, fetare, gjinore, gjuhësore, kombësie, mendimi politik, kushtesh vetjake apo shoqërore, apo mund të rrezikoj të dërgohen në një Shtet tjetër në të cilin nuk është i mbrojtur nga përndjekja për të njëjtat arsye. Sidoqoftë nuk lejohet dëbimi, përjashtu rastet e dëbimit për arsye të rendit publik ose sigurinë së Shtetit të caktuar nga Ministria e Brendshme, ndaj:

Të miturve nën 18 përveç të drejtës për të ndjekur prindin që e ka në ngarkim i cili është i dënuar.

Të huajve që zotërojnë një leje qëndrimi për qëndrim afatgjatë në BE.

Personave të cilët bashkëjetojnë dhe janë qytetarë italianë me të cilin i huaji është i lidhur ose nga marrëdhënie martesore ose nga lidhje familjare brenda shkallës së dytë;

Grave (dhe burrit të tyre) shtatzënë deri 6 muajt pasardhës lindjes së fëmijës.

Kur i burgosuri ndodhet në njërin prej këtyre rrethanave, duhet të lajmërohet më parë Kuestura kompetente për të kërkuar leje qëndrimi dhe për të kundërshtuar dëbimin.

Në çdo rast, i huaji ka të drejtë të kërkojë alternativa ndaj burgimit të parashikuara në Rregulloren e Burgut (besimi në provë shërbimeve sociale, gjysmë liri, burgim në shtëpi, etj.) gjithmonë nëse vendimi i dëbimit nuk e pengon dhënien e tyre. Përdorimi i masave alternative mund të vlerësohet pozitivisht me qëllim rishikimin e gjykimin të rreziqshmërisë shoqërore përsa i përket masës së dëbimit.

Për rinovimin e lejes së qëndrimit, i interesuari duhet t'i drejtohet Zyrës së Matrikullës apo Zyrës së Edukimit, me qëllim që do të marrin formularin e përshtatshëm për të plotësuar dhe nënshkruar për Kuesturën.

Këshillohet gjithmonë të ruhet një kopje e kërkesës, në mënyrë që të mund të paraqitet në Kuesturë pas daljes nga burgju, me qëllim që të

provohet se personi është vënë në lëvizje për rinovimin e lejes, ndërsa ky rinovim ishte ende i vlefshëm.

2. Leja e qëndrimit për arsye të drejtësisë

Mund të jepet me kërkesë të autoritetit gjyqësor, kur prania e të huajit është konsideruar si e domosdoshme për të mbajtur një proces gjyqësor për krime të rënda. Në veçanti, dëshmon që dëshiron të shmanget nga kushtëzimet e një organizate kriminale ose kur kthimi në shtetin e prejardhjes mund të përcaktojë një rrezik për sigurinë e personale dhe për atë të familjes.

Në këto raste, me propozimin e Prokurorit, do të lëshohet një leje qëndrimi për arsye të drejtësisë, e vlefshme për gjashtë muaj, e rinovueshme në qoftë se ndiqet një program për rehabilitim sipas një udjie.

Nëse personi është jashtë vendi dhe dëshiron të kthehet në Itali për të marrë pjesë në një proces gjyqësor që po zhvillohet në të cilin personi është i akuzuar apo viktimë, ai mund të kërkojë, edhe në qoftë se personi ka qenë më parë i dënuar, autorizimin për t'u rikthyer në Itali.

Autorizimi është i kufizuar në bazë të kohës së procesit gjyqësor dhe jepet nga Kuestori.

3. E drejta e përkthimit dhe të përkthyesit

Nëse personi nuk e njih gjuhën italiane, ai ka të drejtë të ketë, pa pagesë, një përkthyes me qëllim të kuptojë akuzën që i bëhet.

Në mënyrë të ngjashme, ai që nuk e kupton gjuhën italiane ka të drejtën e përkthimit të dokumenteve të noterizuara gjatë paraburgimit, në gjuhën që ai njih ose në mungesë, në anglisht, frëngjisht dhe spanjisht, e gjithë kjo për të siguruar ushtrimin e plotë të së drejtës kushtetuese të mbrojtjes.

4. Konventa e Strasburgut

Konventa Ndërkombëtare e Strasburgut (21 mars 1983), ratifikuar nga

Italia më 1988, deklaroi se të arrestuarit në burgjet italiane mund, me pëlqimin e tyre, të vuajnë dënimin në vendin e tyre të origjinës, me kusht që të jenë vende nënshkruese të Konventës.

Dënimi i dhënë nga autoritetet gjyqësore italiane duhet të jetë definitiv dhe të ketë të bëjë me një veprim që është parashikuar nga të dy vendet si krim.

Të shumtë janë shtetet si të Bashkimit Evropian, ashtu edhe jo anëtare të tij, që kanë aderuar në Konventë, mes të cilëve Shqipëria, Ukraina, Moldavia, Rumania, Ekuadori e Peruja, etj..

Dënimi për t'u vuajtur duhet të jetë së paku gjashtë muaj dhe për këtë duhet të bien në ujdi të dy shtetet e interesuara.

Në asnjë rast autoritetet italiane nuk mund të lejojnë që zbatimi i dënimit të dhënë në Itali të kryhet në një vend në të cilin ekziston një rrezik real që personi t'i nënshtrohet trajtimit në kundërshtim me dinjitetin njerëzor.

Për ata që i përkasin një shteti palë të Konventës dhe që do të dëshironin të përfitonin nga një rast i tillë janë në dispozicion formularë të veçantë pranë zyrës së matrikullimit të burgut.

Kërkesa duhet t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Penale, të Faljeve dhe Arkivave, Zyra II - Administrata e Drejtësisë Penale me marrëdhëniet e jashtme - Via Arenula nr. 70-00186 Roma), ose në Ministrinë e Drejtësisë së Shtetit prej vendit nga ai vjen.

Pas shpërnguljes, dënimi i bërë në Itali do të konvertohet në një dënim të parashikuar nga Kodi Penal i shtetit ku po shkon, për të njëjtën shkelje.

Në çdo rast gjendja penale, nuk mund të rëndohet nga konvertimi, pra do të thotë se dënimi nuk do të rritet dhe koha e kaluar në burgjet italiane do të zbritet plotësisht nga dënimi që do të jepet.

Mund të përftohen edhe falje të mundshme dhe masa faljeje, si të Shtetit Italiane ashtu edhe atij që i përket, por çdo shqyrtim i mundshëm i procesit gjyqësor mbetet në kompetencë ekskluzive të Shtetit Italian.

Nëse transferimi bëhet drejt një vendi tjetër të BE-së, procedura është veçanërisht e thjeshtë.

Megjithatë, disa vende jo të BE-së, si Shqipëria, Tunizia dhe Maroku, meqenëse kanë firmosur me Italinë marrëveshje dypalëshe, duhet ta kenë më të thjeshtë procedurën e shpërnguljes për ata që kërkojnë të kryejnë dënimet në atdheun e vet.

SHËNDETI

1. Higjiena

Duhet të zbatohen, me vëmendje të veçantë, rregullat për parandalimin e infeksioneve të llojeve të ndryshme, të cilat kërcënojnë gjithmonë aty ku në hapësira të vogla, jetojnë shumë njerëz.

Personat duhet të organizohen për ta mbajtur të pastër qelitë. Materiali për pastrim vihet në dispozicion falas nga struktura, por është gjithmonë e mundur të blihen, me paratë personale, edhe produkte të tjera.

Nuk është e lejuar për të bërë apo për t'u bërë të tjerëve tatuazhe dhe marrëdhëniet seksuale janë të ndaluara.

Absolutisht nuk rekomandohet shkëmbimi i sendeve për higjienën personale, të brendshmeve, këpucë, etj..

Ruajtja e ushqimit duhet të jetë e kujdesshme dhe frutat e perimet të lahen me kujdes.

Instituti siguron përdorim të mjaftueshme dhe të përshtatshme të lavamanëve dhe të dusheve, si dhe të objekteve e tjera të nevojshme për kujdesin dhe pastrimin e personit. Dushi kurrë nuk duhet të bëhet zbathur për të shmangur infezionin.

Organizohet një shërbimi periodik për prerjen e flokëve dhe ruajtjen e mjekrës. Mund të lejohet përdorimi i makinës së rrojës elektrike personale.

Prerja e flokëve dhe ruajtja mund të detyrohet vetëm për arsye të veçantë higjieniko-sanitare.

2. Mënyra e të jetuarit

Është e këshillueshme që të bëhet një jetë sa më e shëndetshme,

brenda kufizimeve të imponuara nga gjendja e vendit ku kryhet dënimi. Të bësh gjimnastikë apo sidoqoftë të lëvizësh është shumë e rëndësishme për shëndetin, si edhe shfrytëzimi i çdo mundësie për të qëndruar në ajër të pastër. Lejohet, përveç në raste të veçanta, të qëndrohet të paktën dy orë në ditë në ajër të pastër.

Qelia duhet ajrosur shpesh, duke mbajtur dritaren hapur.

3. Ndhima shëndetësore

Me hyrjen në Institut, i burgosuri i nënshtrohet një vizite mjekësore për të parë nëse ka sëmundje fizike ose mendore. Kujdesi shëndetësor duhet të sigurohet nëpërmjet vizitave të rregullta dhe të shpeshta, pavarësisht nga kërkesat e të interesuarve. Duhet të zhvillohen me rregullsi veprimtari parandaluese mjekësore që të zbulojnë dhe të ndërhyjnë për të shmangur kështu zhvillimin e formave patologjike, që burojnë edhe nga situata të zgjatura të qëndrimit pasiv dhe të kufizimit të lëvizjeve e veprimtarisë fizike.

Kërkesa mjekut të Institutit i bëhet, me anë të një kërkesë drejtuar agjentit në shërbimeve në seksion, duke treguar mbiemrin. Nëse i burgosuri ndien një keqësim të papritur lind e drejta për një vizitë urgjente.

Të dhënat shëndetësore janë konfidenciale dhe mjekët janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional.

Të burgosurit, nga pikëpamja e kujdesit shëndetësor, kanë të njëjtat të drejta si qytetarët e lirë. Bëhen falas, nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar, vizitat mjekësore të përgjithshme, specialistike dhe analizat klinike, si: analiza e urinës dhe e gjakut, radiografitë e elektrokardiogrami, etj., si edhe dhënia e ilaçeve. Është e mundur që ilaçet të blihen me recetë të mjekut.

Është e mundur, me lejen e Drejtorit, vizita e një mjeku të jashtëm të i

cili i burgosuri ka besim, me shpenzime personale.

Parashikohey izolimi për ata që vuajnë nga sëmundjet ngjithëse, apo të dyshuar si të sëmurë.

Në rast të dyshimit për sëmundje mendore, merren pa hezituar masat e rastit, duke respektuar rregullat në lidhje me kujdesin e shëndetit psikiatrik dhe të shëndetit mendor.

Është e ndaluar të grumbullohen barna dhe t'u jepen të burgosurve të tjerë.

Në çdo institucion ku janë të pranishme gra, janë në punë shërbime të veçanta për kujdesin shëndetësor për gratë shtatzëna dhe në gji.

Nënave u lejohet të jetojnë me fëmijët e tyre derisa këto të mbushin moshën tre vjeç. Për trajtimin dhe kujdesin e fëmijëve janë krijuar çerdhe të veçanta.

Në rajonin Kampanja i vetmi institucion i pajisur me një çerdhe është ai në Avellino.

Të burgosurit mund t'i lejohet të kujdeset, jashtë burgu, për fëmijët me moshë deri në 10 vjeç, me kushtet e parashikuara si për punën jashtë, për sa kohë është në përputhje.

Nëse nëna ka vdekur ose në pamundësi dhe nëse nuk ka asnjë mënyrë për t'ia besuar fëmijët askujt tjetër përveç babait, ky mund të përfitojë përkujdesjen ndaj fëmijëve jashtë burgu.

4. Varësia nga droga

Legjislacioni kombëtar në këtë fushë parashikon që individët me varësi droge, që janë të nënshtruar ndaj një mase dënimi, kanë të drejtë për të njëjtin trajtim që u ofrohet qytetarëve toksikomanë italianë të lirë, në ngarkim të Shërbimit Toksikoman të Ndërmarrjeve Shëndetësore Lokale.

Në zbatimin e këtyre parimeve të së drejtës, Departamentit i të Varurave nga droga i Ndërmarrjeve Shëndetësore Lokale NAPOLI 1 ka krijuar

Njësinë Vepruese së Shërbimit Toksikoman (NJVT Shër.T Zonës Penale), e cila vepron brenda Burgut Poggioreale dhe Qendrës së Burgimit Secondigliano, përmes dy grupeve punonjësish me specializime të ndryshme (mjekë, psikologë, punonjës socialë), në bashkëpunim me ente dhe shoqata të sektorit të tretë.

NJVT Shër. T. Zona Penale siguron në mënyrë të veçantë:

Lidhje me NJVT Shër.T me prejardhje nga subjekte të dënuar toksikomanë për të siguruar:

vazhdimësinë e terapive farmakologjike dhe psikosociale; vlerësimin dhe orientimin drejt programeve të përshtatshme si alternativë ndaj burgimit; shoqërimin, gjatë fazës së liritimit të subjektit, në shërbimet territoriale kompetente që të vazhdojë ta marrë përsipër dhe për të parandaluar rrezikun e mbidozës dhe në përgjithësi mënyrën e rezikshme të të jetuarit shëndetësor dhe shoqëror.

Shërbimet që jepen janë si më poshtë:

Pritje e vlerësim i gjendjes shëndetësore dhe i problematikave psikologjike e shoqërore, si edhe orientim për kurim.

Trajtime Farmakologjike, psikologjike dhe shoqërore në lidhje me format e ndryshme të varësisë nga substanca narkotike dhe psikoaktive.

Vizita mjekësore, analiza të ndryshme dhe marrja në ngarkim e gjendjes shëndetësore në përgjithësi.

Mbështetje psikologjike për ata që bëjnë kërkesë.

Këshillim shoqëror, ndihmë dhe shoqërim në procesin e gjetyes dhe të vënies në jetë të masave alternative të burgimit në marrëveshje me NJVT Shër.T të Ndërmarrjes Shëndetësore Lokale të prejardhjes dhe të kompetencës territoriale.

Këshillim dhe drejtim familjeve të të burgosurve.

Kanë të drejtë për ndihmën e Shër.T NJVT të gjithë të burgosurit që, me hyrjen e tyre në Institut, deklarohen të varur nga droga, apo të burgosurit toksikomanë që e kërkojnë atë, pasi janë caktuar në një repart të Institutit.

Ekipi i NJVT Shër.T e kryer veprimtarinë e vet si në Burgun e Poggioreale-s, ashtu edhe në Qendrën e Burgimit në Secondigliano nga e hëna deri të dielën, nga ora 08.00 deri në orën 14.00, gjatë gjithë vitit.

NJVT Shër.T Fusha Penale e Departamentit të të Varurve nga droga bashkëpunon ngushtë me Zyrën për Zbatimin Penal Jashtë (ZZPJ), me Institutet për Burgimin e Zbutur (IBZ) të Kampanjës, me Bashkinë e Napolit dhe me ndërmarrjet e sektorit të tretë për të gjitha veprimtaritë e lidhura me masat alternative dhe me integrimin shoqëror.

Ekipi i NJVT Shër.T Fusha Penale ofron ndihmën dhe këshillimin e Avokatëve pranë sekretarisë së burgjeve të të dy Instituteve të burgimit apo pranë selive të veta të punës.

Për kontakte

Selia qendrore:

c/o Departamentit të varësisë nga droga ASL NA1 Via Manzoni n.249
tel.0812547683; 0812547652

Selitë e punës:

c/o Casa Circondariale Poggioreale tel 19575207
c/o Secondigliano Prison tel 081069419

5. SIDA

Një aspekt vendimtar për kontrollin e infeksionit dhe në veçanti të HIV-it në burg, ka dhënia dhe kryerja e testit të hyrjes të të dënuarit në burg.

Gjithsesi është e domosdoshme për të marrë “pëlqimin e informuar”, të nënshkruar të të dënuarit. Testi bëhet i detyrueshëm vetëm në disa kushte klinike të tilla sa të kërkohej analiza për qëllime terapie apo profilaktike edhe nëpërmjet Trajtitimit të Detyrueshëm Shëndetësor (TDSH).

Kujdesi ndaj të burgosurve të infektuar me HIV duhet të udhëhiqen nga Njësia e Punës kompetente për sëmundjet ngjitëse vendore. Duhet, gjithashtu, të sigurohet në të gjitha objektet e dënimit, furnizimi i vazhdueshëm me barna antiretrovirale.

Vendoset “shtyrja e detyrimisht e dënimit”, kur i burgosuri është duke vuajtur nga:

SIDA e shpallur, mungesë e rëndë imuniteti (CD4 e barabartë apo më e vogël se 200 qeliza / ml në kontrole të njëpasnjëshme. Indeksi i Karnofsky <50 (Shih progresionin e shkallës Karnofsky). Sëmundje të tjera serioze me një gjendje mjekësore të papajtueshme me burgimin.

SHPENZIMET E GJYQIT DHE MBAJTJA NË BURG

1. Shpenzimet

Shpenzimet që i ka përbulluar Shteti për bërjen e procesit gjyqësor dhe për mbajtje në burg duhet, në rast dënimi, të paguhet nga i interesuari.

Kuota e përditshme për mbajtjen në burg aktualisht është 1,80 € Në të janë të përfshira koston e vakteve dhe përdorimi i kompletit personal, të siguruar nga Administrata e Burgut (dyshek, çarçafë, pjata, etj..)

2. Falja e borxhit

Shpenzimet e gjykatës dhe të mbajtjes në burg nuk pagohen nëse personi është në kushte ekonomike në nevojë dhe ka mbajtur një sjellje të rregullt gjatë burgimit.

Kërkesa duhet t'i paraqitet Gjykatës së Mbikëqyrjes, pas njoftimit për pagesë. Kërkesa pezullon procedurën për marrjen e shumës.

3. Për të burgosurit punëtorë

Në rast të pranimit të kërkesës për faljen e borxheve, personi nuk është më i detyruar të paguajë shpenzimet e mbajtjes, përveç atyre që lidhen me periudhën në të cilën personi ka punuar.

Për një periudhë të tillë, në të vërtetë, shumat e detyruar do të mbahet nga shpërblimi të cilin e gëzon, të marra nga fondi i kufizuar (shih, kapitulli IV, paragrafi 6)

LIRIMI NGA BURGU

1. Liria

Drejtori e Institutit, me të marrë urdhër nga Autoriteti Gjyqësor kompetent apo i Sigurisë Publike, i kthen menjëherë lirinë të burgosurit kur mungojnë arsyet që justifikonin burgimin.

Drejtori i Institutit lajmëron për masën që do të merret së shpejti, të paktën tre muaj më parë, ZZPJ-në, duke i bërë të ditur të gjitha të dhënat e nevojshme për ndërhyrjet dhe kujdesin e duhur.

Ku nuk mund të ketë një parashikim të tillë tre muaj para, Drejtori bën njoftimin kur vihet në dijeni të vendimit.

Kur bëhet kërkesa nga personi që lirohet nga burgu, Këshilli i Disiplinës së Institutit lëshon një vërtetim për ndonjë Kualifikim të mundshëm profesional, si edhe të dhëna objektive në lidhje me sjelljen e mbajtur.

Instituti kujdeset për një komplet veshjeje për atë që nuk ka dhe në qoftë nuk është në gjendje për të shkuar në shtëpi me shpenzimet e veta atëherë i paguhet rruga.

Personave që banojnë jashtë vendi, u jepen biletat e nevojshme për të arritur konsullatën e vendit ku banon.

Dorëzohen gjërat e mbajtura në çastin e hyrjes në Institut dhe të hollat.

NGA ANA E FAMILJES**1. Ndjenja e humbjes**

Kur një i afërm, një mik arrestohet, kush ia do të mirën provon një ndjenjë humbjeje, zbrazësie të papritur, pafuqie të plotë. I hiqet këtij personi liria dhe nëse kjo ndodh për herë të parë, askush nuk di si të silltet. Rrethanat e kohës dhe të vendit në përgjithësi nuk janë të favorshme, sepse arrestimi ndodh herët në agim dhe të gjithë ndihen edhe më të vetmuar.

Çfarë duhet të bëhet kur po arrestojnë një person që e duam?

2. Avokati

Para së gjithash shikoni se cili është Autoriteti që nënshkruan masën, dhe kontaktoni menjëherë me avokatin që gëzon besimin tuaj. Nëse nuk njihni një avokat që të mund të interesohet për çështjen, drejtohuni diku ku mund t'ju japin të dhëna për caktimin e një avokati. Në mungesë, verifikoni, në masën kufizuese të dhënë, emrat dhe adresat e mundshme të një mbrojtësi zyre.

Marrëdhënia me avokatin është e rëndësishme, sepse është një figurë e detyrueshme dhe thelbësore për gjithçka që do të ndodhë.

Nëse gjendesh në kushte veçanërisht të vështira ekonomike Shteti merr përsipër të gjitha shpenzimet. Kështu ke të drejtë të mos paguash mbrojtësin, shpenzimet gjyqësore, këshilltarët e mundshëm apo hetuesit.

Për t'u pranuar në ndihmën falas është e nevojshme të kesh një pagë më të ulët se 9,723.48 Euro, plus 1,032.91 Euro për çdo person në moshë madhore që bashkëjetojnë në familje. Për llogaritjen,

duhet t'u shtohen të ardhurat personale ato të personave të tjerë që bashkëjetojnë.

Janë përjashtuar nga kjo ndihmë ligjore të dyshuarit dhe të dënuarit për krimin e mospagimit të taksave.

Vetëm mbrojtësit e regjistruar në Urdhrin e veçantë të ndihmës ligjore falas janë të autorizuar për ta kryer këtë detyrë. Regjistri është në dispozicion të Këshillit të Urdhrit të Avokatëve të Napolit.

Emërimi, deri kur të mos jetë kujdesur i arrestuari, mund të bëhet nga një i afërm, me një deklaratë që i bëhet Autoriteti Gjyqësor në procedurë, domethënë i caktuar atij nga mbrojtësi apo bërë me dije me letër rekomande.

Në mungesë të emërimit të një personi të besuar, mbetet e vlefshme ajo e mbrojtësit të zyrës të caktuar nga Autoriteti Gjyqësor. Mbrojtësi i zyrës duhet të paguhet.

Avokati do të bëjë të ditur hapat që kërkon procedura.

3. Pozita juridike

Pasi të merret vesh se në cilin Institut do të burgoset personi, familja duhet të informohet për repartin apo sektorin në të cilin është caktuar, si edhe të njohë situatën e tij ligjore. Nga këta dy elemente varet sasia dhe cilësia e marrëdhënieve të mëvonshme.

4. Bisedat, pakot, posta, telefonatat

Këto janë mjete me të cilat të afërmit mund të lidhen me familjarin e tyre që kanë në burg. Për të verifikuar kushtet dhe mënyra përkatëse lexo Kreun V dhe Shtojcën. Në këtë të fundit janë të përmbajtura rregullat dhe sjelljet e secilit Institut.

1. Garanti i personave që u janë nënshtruar masave kufizuese të lirisë personale

Nuk ekziston figura e “Garantit” në nivel kombëtar, edhe pse ka kohë që janë bërë disa projektligje. Disa Ente Lokale, si Rajoni Kampanja, janë kujdesur për një emërim të tillë.

“Garanti” - i themeluar nga Këshilli Rajonal Kampanja - siguron organizimin e punës dhe të shërbimeve që kanë të bëjnë me të drejtën e shëndetit; përmirësimin e cilësisë së jetës; arsimimin; ndihmesën fetare; formimin profesional dhe çdo punë që ka për qëllim rifitimin, ri-integrimin shoqëror dhe përfshirjen në botën e punës.

“Garanti” ka të drejtë të hyjë në Institut me nismën e vet ose me kërkesën e të tretëve.

Zyra e Mbrojtësit mund të kontaktohet nga të burgosurit ose familjet e tyre në këto mënyra:

me postë, duke shkruar në adresën: Zyra e Mbrojtësit të të drejtave të burgosurve, Qendër is. F8 - Napoli;

me telefon, me anë të numrave 0817783132-3852;

me anë të postës elektronike në: garante.detenuti@consiglio.regione.campania.it

2. Aspekte të ndryshme organizative

Çdo Institutit disiplinon, në varësi të nevojave strukturore dhe organizative:

- a) oraret e hapjes dhe të mbylljes;
- b) oraret që kanë të bëjnë me organizimin e jetës së përditshme;
- c) mënyrat që kanë të bëjnë me kryerjen e shërbimeve të ndryshme;
- d) kohën e kaluar në hapësirat e përbashkëta;
- e) oraret, turnet dhe mënyrat e qëndrimit jashtë;
- f) kohën dhe mënyrat e veçanta për takimet edhe për korrespondencën telefonike;
- g) afishimet e lejuara dhe mënyrat;
- h) lojërat e lejuara.

PYETËSOR I INSTITUTEVE TË RAJONIT KAMPANIA

PARAPRAKISHT

A është i pajisur me një rregullore të brendshme Instituti i drejtuar nga ju?

ARIANO IRPINO: *Po*

ARIENZO: *Po*

AVELLINO: *Është përgatitur, por ende nuk është miratuar*

BENEVENTO: *Po, por ende nuk është miratuar*

CARINOLA: *Po*

EBOLI: *Jo*

LAURO: *Po*

O.P.G. AVERSA: *Është përgatitur, por ende nuk është miratuar*

O.P.G. NAPOLI: *Po*

POGGIOREALE: *Rregullorja është përpiluar dhe është duke u shqyrtuar në Gjykatën e Mbikqyrjes*

POZZUOLI: *Po*

S. ANGELO DEI LOMBARDI: *Jo. Rregullorja e brendshme është përgatitur dhe është në pritje të miratimit të Ministrit*

S. M. C. VETERE: *Po*

SALA CONSILINA: *Po, që nga data 22/02/2008*

SALERNO: *Po*

SECONDIGLIANO: *Jo*

VALLO DELLA LUCANIA: *Po, por ende nuk është miratuar*

A dorëzohet në çastin e hyrjes në institutin e dënimit kopja e rregullores?

ARIANO IRPINO: *Jo gjithmonë*

ARIENZO: *Jo*

AVELLINO: *Jo*

BENEVENTO: *Jo*

CARINOLA: *Është në dispozicion të tël dënuarve*

EBOLI: *///*

LAURO: *Jo, ndodhet në bibliotekë*

O.P.G. AVERSA: *Jo*

O.P.G. NAPOLI: *Jo, vetëm për t'i hedhur një sy. Nuk i dorëzohet kopje për mungesë të letrës për fotokopje*

POGGIOREALE: *///*

POZZUOLI: *Jo*

S. ANGELO DEI LOMBARDI: *Jo, shpjegohen rregullat themelore të institutit*

S. M. C. VETERE: *Jo*

SALA CONSILINA: *Jo*

SALERNO: *Po*

SECONDIGLIANO: *///*

VALLO DELLA LUCANIA: *Jo, vihen*

në dizeni me zë

Në rastin kur nuk ka një rregullore të brendshme a ka gjithsesi një tërësi rregullash të shkruara, që kanë të bëjnë me rregullat kryesore (në kuptimin e të drejtave dhe të detyrave), që duhen respektuar brenda institutit?

